

**PRIVATIZIMI DHE  
POST- PRIVATIZIMI NË  
KOSOVË :**

**NJE GOTË GJYSMË BOSH APO  
GJYSMË E PLOTË?**

(Raport studimor)

Shtator 2008  
Prishtina

**Autorët:**

Muhamet Mustafa  
Artane Rizvanolli  
Alban Hashani  
Alban Zogaj  
Lumir Abdixhiku  
Fadil Aliu  
Besnik Krasniqi  
Durim Hoxha

**Konsulent:**

Iraj Hashi, Staffordshire University  
Muhamet Sadiku, Riinvest

**Botues: Forum 2015**

Mbështetur nga: Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, Friedrich Ebert Stiftung, Zyra Holandeze dhe Riinvest Institute  
Dizajni, faqosja dhe shtypi: "Adnan Reznici CO"  
Kopje: 500

# PËRMBAJTJA

## 5 PERMBLEDHJE DHE KONKLUZIONE

Rekomandime

## 9 HYRJE

## 11 GJENDJA AKTUALE E PRIVATIZIMIT TE NSH-të E KOSOVES

## 13 PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE EMPIRIKE MBI EFEKTET E PRIVATIZIMIT NË EKONOMITË NË TRANZICION

Dinosaurët apo firmat e reja

Punësimi dhe menaxhimi para dhe pas privatizimit

## 15 PERFORMANCA E KOMPANIVE TË PRIVATIZUARA NË KOSOVË

Përmbledhje statistikore e profilit të kompanive

Kompanitë joaktive

Qarkullimi

Punësimi

Eksportet

## 23 RISTRUKTURIMI I NDËRMARRJEVE

## 25 FINANCIMI DHE INVESTIMET NË KOMPANITË E PRIVATIZUARA

## 27 PERCEPTIMI I MJEDISIT BIZNESOR

Barrierat në zhvillimin e biznesit

Konkurrenca

Korrupsioni

## 33 ÇËSHTJET E LIDHURA ME PROCESIN E PRIVATIZIMIT

Dorëzimi dhe Menaxhimi

Të Drejtat e Punëtorëve

Të ardhurat e Privatizimit dhe funksioni i tyre ekonomik

## 36 REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA

## 39 SHTOJCAT

## **SHKURTESAT**

**AKM – Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit**

**AKP – Agjencioni Kosovar i Privatizimit**

**BE – Bashkimi Evropian**

**BPV – Bruto produkti vendor**

**BSPK – Bashkimi i sindikatave të pavarura të Kosovës**

**ECO – European Consultants Organization**

**FES – Friedrich Ebert Stiftung**

**FMN – Fondi monetar ndërkombëtar**

**IJD – Investimet e jashtme direkte**

**MTI – Ministria e tregtisë dhe industrisë**

**NVM – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme**

**NSH – Ndërmarrjet Shoqërore**

**OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian**

**OSI – Open Society Institute**

**SPSS – Statistical Package for Social Sciences**

**SHPK – Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**

**UNMIK – United Nations Mission in Kosovo**

## PERMBLEDHJE DHE KONKLUZIONE

Ky raport është përgatitur sipas programit të Forum 2015 për të përmirësuar nivelin e informimit të aktorëve që krijojnë politikat dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Gjithashtu synimi i këtij raporti është që të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë e sidomos të ndikojë në përmirësimin e politikave për përfundimin e suksesshëm të këtij procesi të rëndësishëm. Raporti është bazuar në anketën e 75 ndërmarrjeve të përzgjedhura në mostër nga Regjistri elektronik i AKM sipas metodës së rastësishme, veç kësaj janë anketuar të gjitha ndërmarrjet e privatizuara me metodën speciale të spin off-it (23sosh). Aktivitetet kërkimore kanë përfshirë edhe 7 studime rasti (kompani të privatizuara) si dhe intervista me Bashkimin e Sindikatave të pavarura të Kosovës. Tanimë privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore (NSH) të Kosovës ka hyrë në fazën finale. Mirëpo ai është zhvilluar me shumë vështirësi. Para dhe menjëherë pas fillimit të tij, në korrik të vitit 2003, privatizimi ka qenë i shoqëruar me dilema dhe kundërshtime të shumta të cilat shpesh kanë ndikuar në ngadalësimin e edhe në ndërprerjen e tij të përkohshme. Pas një periudhe hezitimi procesi i privatizimit rifilloi me 2004. Prej fillimit e deri tash AKM ka shpallur tender për privatizim të 313 NSH-ve, përkatësisht 551 kompanive të reja (New Co-s<sup>1</sup>) të krijuara me ndarje e tyre nga ish NSH-të me metodën spin off. Megjithatë kontratat e shitblerjes deri me tani i kanë përfunduar vetëm 347 blerës. Fondet e akumuluar nga shitja e aseteve të NSH-ve kapin shumën mbi 383 milion Euro apo të rreth 11.5% të GDP (BPV)<sup>2</sup> (KTA Management Information Summary, 2008). Megjithatë këto fonde edhe më tutje mbahen të ngrira në Fondin e mirëbesimit të AKM të tërhequra nga aktiviteti dhe funksioni ekonomik. Po ashtu ka qenë e pranishme një vonesë kronike e pagesës së fondeve që u përkasin punëtorëve (20% nga vlera e aseteve të shitura). Vlerësohet se kanë mbetur për tu shpallur për privatizim rreth 100 NSH, duke përfshirë këtu edhe disa ndërmarrje të rëndësishme siç janë kompanitë si Trepça dhe terrenet e skijimit në Brezovicë, gjithashtu mbetet që përfundimisht të zgjidhet statusi i ish NSH-ve të Gjakovës. Konsiderohet se një pjesë e madhe e ndërmarrjeve tjera do të nënshtrohen procedurës së likuidimit.

Për shkak të problemeve të shfaqura me kosovarizimin e AKM që nga fillimi i këtij, për rreth 8 muaj, procesi i privatizimit pothuajse është ndërprerë. Krahas vonesës në themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dolën edhe shumë probleme rreth pranim dorëzimit të dokumentacionit dhe punëve në zhvillim e sipër si dhe rreth fillimit të punëve të kësaj Agjencie. Më në fund në Shtator të këtij viti u mbajt mbledhja e parë e Bordit të AKP-së në të cilën edhe u shpall vala e 32 kompanive për privatizim. Disa nga konstatimet e rëndësishme lidhur me rezultate e procesit të privatizimit dhe për gjendjen në ndërmarrjet e post- privatizuara janë

- Ndryshimet pronësore pas privatizimit ( privatizimi dytësor) kanë qenë të vogla; vetëm 15% , apo një në 6 ndërmarrjet e privatizuara është shitur sërish. Ndërmarrjet e reja (New co's) janë organizuar më shumë si ortakëri<sup>3</sup> dhe korporata<sup>4</sup> në krahasim me NVM apo bizneset tjera private

1 'NewCo' është kompani e krijuar nga shitja e NSH-së përmes metodës së spin off-it në procesin e privatizimit.

2 GDP në 2007 vlerësohet të ketë qenë 3,343 (në milion Euros); Burimi: IMF, Prill 2008

3 Ortakëria është një lloj i entitetit biznesor në të cilin partnerët (pronarët) ndajnë fitimin dhe humbjet nga ndërmarrësia e tyre; mund të ketë përgjegjësi të plotë apo të kufizuar.

4 Korporata është një lloj i entitetit biznesor që ka përgjegjësi të pakufizuar.

(50% ndaj 13%). Ato të shumtën janë kompani me përgjegjësi të kufizuar (70%) për dallim nga NVM të cilat me shumicë të madhe (80%) janë me përgjegjësi të plotë.

- Motivet kryesore të investitorëve për të marrë pjesë privatizim kanë qenë mundësia e sigurimit të punëtorëve dhe niveli i pagës, lokacioni gjeografik dhe burimet natyrore;
- Efektet e privatizimit janë zvogëluar nga ngadalësia dhe vonesat e mëdha në lidhjen e kontratave dhe marrjen në disponim të ndërmarrjeve nga blerësit fitues. Mesatarisht nënshkrimi i kontratave është bërë pas shtatë muajve nga shpallja e fituesve ndërsa janë nevojitur edhe 3-5 muaj për të marrë në dorëzim ndërmarrjet.
- Performanca (rezultatet e punës) e ndërmarrjeve të privatizuara duket të jetë më e mirë se sa është menduar. Dinamika e rritjes së shitjeve, eksportit, punësimeve dhe investimeve është më e shpejtë se sa pjesa tjetër e sektorit privat. Rritja me dinamike e GDP dhe eksportit në Kosovë gjatë dy viteve të fundit është mbështetur edhe nga dinamika më e madhe e procesit të privatizimit gjatë viteve 2005, 2006 dhe 2007. Qarkullimi (shitja) e ndërmarrjeve të post privatizuara është dyfishuar gjatë vitit 2007 në krahasim me vitin 2006, ndërkaq brenda kësaj periudhe eksporti i tyre është rritur gjashtë herë, investimet janë rritur rreth 30%. Ndërkaq shfrytëzimi i kapaciteteve në këto ndërmarrje është rreth 55% që do të thotë se ato kanë hapësirë për rritje të mëtejme. Pjesëmarrja mesatare e eksportit në shitjet e këtyre ndërmarrjeve 35%, ndërsa eksportet e tyre mbulojnë importin e tyre me 46% për dallim nga ekonomia e Kosovës në tërësi ku mbulimi importit me eksport është vetëm 11%. Rreth 80% e menaxherëve të anketuar konsiderojnë se biznesi i tyre ka pasur ngritje në vitin 2007 në krahasim me 2006 dhe presin se ky vit do të jetë edhe më i mirë.
- Shumica e ndërmarrjeve – kompanive të reja që kanë lindur nga privatizimi kanë vazhduar aktivitetin e mëparshëm biznesor, ndonëse afër 40% prej tyre kanë zgjeruar programet e tyre me produkte dhe shërbime të reja dhe kanë bërë ndryshime teknologjike.
- Numri i të punësuarve zakonisht është zvogëluar menjëherë pas privatizimit, por më vonë në shumicën e rasteve ka filluar të rritet. Tani rreth 60% e të punësuarve kanë punuar në këto kompani edhe para privatizimit. Shumica e tyre (60%) kanë rekrutuar punëtorë të rinj. Sipas vlerësimeve të menaxherëve numri i punëtorëve në këto kompani do të duhej të rritej për rreth 9% gjatë vitit 2008 në krahasim me vitin 2007.
- Tek këto kompani është një orientim më i fortë kah eksporti - rreth 44% e kompanive besojnë se do të eksportojnë.
- Sipas përgjigjeve të të anketuarve më tepër se 80% e këtyre ndërmarrjeve kanë bërë investime duke angazhuar të shumtën burimet e veta financiare dhe mbështetur me rreth 1/3 nga kreditë bankare të cilat konsiderohen si të pafavorshme për pjesën dërmuese (80%).
- Megjithatë rezultatet pozitive të prezantuara më lartë zbehen dukshëm kur të kihet parasysh se rreth 1/3 e ndërmarrjeve pas privatizimit nuk janë aktive dhe nuk gjenerojnë vlerë të re.
- Kompanitë e privatizuara nëpërmjet likuidimit kanë rezultate relativisht të mira në krahasim me pritjet duke arritur qarkullime më të mëdha për një punëtor se sa ndërmarrjet e privatizuara me spin off special.

## Rekomandime:

- I rekomandohet qeverisë që të mbështesë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), të krijuar rishtas, që të konsolidojë sa më shpejtë aktivitete e saja për të vazhduar me sukses procesin e privatizimit. Në këtë aspekt është e nevojshme sidomos që: (a) të përmyllet pranim dorëzimi zyrtar sa më i shpejtë i operacioneve, dokumentacionit dhe bazës së të dhënave nga AKM në AKP dhe (b) të krijohen praktika plotësisht transparente dhe të raportimit ndaj investitorëve, opinionit publik, Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës.
- AKP duhet të marrë masa të menjëhershme për të lidhur kontratat që presin për tu përfunduar nga rundet e mëparshme dhe të ndërtojë procedura me efektive të transferit të kompanive tek blerësit – duke e shkurtuar tërë procesin e kontraktimit dhe bartjes së ndërmarrjeve mundësisht brenda një tremujori.
- Duke pasur parasysh brengat e investitorëve dhe pronarëve të rinj të ndërmarrjeve të privatizuara i sugjerohet qeverisë që sa më shpejtë të bëjë përmirësime në politikat ekonomike për t'i bërë ato më të favorshme për investitorët. Veçanërisht sugjerohet që: (a) të lirohen nga pagesa e tarifave doganore dhe tu mundësohet një kreditim afatgjatë për pagesën e TVSH për pajisjet e importuara për investimet kapitale (b) përmirësohet qasja në kredi duke rritur ofertën kreditore dhe përmirësuar kushtet e kreditimit (për shembull me vija të veçanta kreditimi) për prodhim, eksport e të ngjashme.
- AKP duhet të krijojë një sistem efektiv të pagesës së 20% të fondeve të privatizimit që u takojnë punëtorëve duke ndërtuar një bashkëpunim më të mirë me sindikatat dhe krijuar edhe kushtet e nevojshme teknike;
- I rekomandohet Qeverisë që të punojë për të gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë me të cilën do të sigurohej angazhimi i fondeve të privatizimit në rrjedhat ekonomike të vendit duke investuar ato në biznese me kushte më të mira nëpërmjet sistemit bankar (vija kreditore të veçanta). Njëkohësisht sugjerohet që të krijohet Fondi i restitimit (nga 10 -15% e fondeve të privatizimit për të kompensuar kërkesat eventuale të arsyeshme të kreditorëve ndaj këtyre fondeve).





## HYRJE

Tanimë privatizimi në Kosovë ka hyrë në fazën përfundimtare. Megjithatë ky proces ka qenë i shoqëruar me shumë dilema para se të fillojë te cilat kanë vazhduar edhe pas raundit të parë në korrik të vitit 2003, kur për një kohë edhe u ndërpre. Duke rifilluar përsëri me 2004 gjatë tri viteve vijuese ai pati një dinamikë të lakmueshme kështu deri tani janë shpallur tenderë për 313 NSH, përkatësisht 515 të rikrijuara nga këto të parat sipas metodës së ashtuquajtur spin off. Megjithatë deri tani vetëm për 347 raste ka përfunduar nënshkrimi i kontratave. Fondet e akumuluar nga shitja e asetëve kanë arritur shumë prej 383 milion Eurosh dhe tanimë përbëjnë rreth 11.5 % të GDP. Fatkeqësisht këto fonde vazhdojnë ende të mbahen të bllokuara në fondin e mirëbesimit të tërhequra nga rrjedhat e aktiviteteve ekonomike të vendit. Instituti Riinvest që nga fillimet e hershme të tranzicionit ka qenë shumë i angazhuar me aktivitete kërkimore dhe aktivitete nxitëse e advokuese për të zbatuar një program efektiv të privatizimit. Gjatë periudhës 2001-2005 kemi publikuar 4 raporte lidhur me aspektet e ndryshme të privatizimit në Kosovë. Këto raporte përmbajnë argumente teorike dhe të tjera në favor të zbatimit të privatizimit dhe vejnë pah pasojat negative për shoqërinë dhe ekonominë Kosovare nga hezitimet dhe vonesat që e shoqëruan këtë proces në Kosovë. Këto raporte po ashtu japin një pasqyrë të metodave të ndryshme dhe të efekteve të tyre në ekonominë e ndryshme në tranzicion.

Megjithatë, përkundër një numri të konsiderueshëm të NSH të privatizuara gjatë tri viteve të fundit nuk ka pasur një studim që do të pasqyronte në mënyrë më gjithëpërfshirëse performancën e ndërmarrjeve të privatizuara, efektet e tyre në ekonomi, aspektet sociale e edhe ndikimin e mjedisit biznesor në punën e këtyre ndërmarrjeve. Informacioni se çfarë po ngjet me ndërmarrjet e privatizuara ka qenë shumë i fragmentuar dhe në të shumtën e rasteve i lidhur për ndërmarrje të caktuara dhe në rastet kur janë paraqitur probleme rreth transformimit dhe aktivitetit të tyre<sup>5</sup>.

Ky raport është përgatitur sipas programit të Forumit 2015 për të ndriçuar disa nga aspektet e rëndësishme të këtyre çështjeve e sidomos për : (a) të përmirësuar informacionin e krijuesve të politikave dhe vendimmarrësve dhe aktorëve të tjerë të interesuar për efektet e privatizimit në Kosovë dhe (b) për të nxitur aktivitete për përmirësimin e transparencës dhe përgjegjësisë e sidomos të politikave publike për ta përmbyllur me sukses këtë proces të rëndësishëm.

<sup>5</sup> Deri me tani është bërë i njohur vetëm një studim që ka vlerësuar performancën dhe kontributin e ndërmarrjeve të privatizuara . Hulumtimi i ECO organizate konsulentë të angazhuar nga AER ka qenë i përqendruar në sektorin e prodhimit dhe shërbimeve dhe prezanton një fotografi me ngjyra shumë pozitive mbi efekte të privatizimit në Kosovë: punësimi është rritur 23% në kompanitë e anketuara pas privatizimit, ndonëse nuk ka informacion mbi ndryshimet në krahasim me periudhën para privatizimit . Studimi konstaton edhe një rritje prej 26% në qarkullimin e këtyre ndërmarrjeve gjatë muajve të parë të 2007 në krahasim me mesataren e 2006, duke raportuar gjithashtu edhe një vlerë të eksporteve të 55 kompanive prej €557,000. Nga studimi nuk është e qartë se sa këto rezultate mund të përgjithësohen për sektorët e caktuara pasi që nuk është e qartë teknika përcaktimit të mostrës dhe sa është ajo reprezentative. Raporti po ashtu nuk trajton problemin e kompanive që nuk janë aktive pas privatizimit.

Raporti është strukturuar në këtë mënyrë: Kapitulli i parë trajton stadin aktual të zhvillimit të procesit të privatizimit të NSH-ve në Kosovë. Në kapitullin e dytë jepet një pasqyrë e trajtimeve mbi efektet e privatizimit në ekonominë në tranzicion. Kapitulli i tretë merret me performancën e ndërmarrjeve të privatizuara duke bërë edhe krahasime me ndërmarrjet të cilat që nga fillimi janë themeluar si ndërmarrje private. Kapitulli i katërt i dedikohet nivelit të ristrukturimit që po zhvillohet në ndërmarrjet e privatizuara në aspektin e menaxhimit , programit prodhues investimeve dhe ndryshimeve në teknologji. Kapitulli i pestë trajton problemet e investimeve dhe financimit ndërsa i gjashti prezanton perceptimet e udhëheqësve të ndërmarrjeve të privatizuara lidhur me mjedisin biznesor, pengesat në zhvillimin e bizneseve, konkurrencën dhe korrupsionin, pra kushtet nën të cilat ndërmarrjet e privatizuara zhvillojnë aktivitetin e tyre . Kapitulli 7 shtjellon edhe disa çështje tjera që lidhen me zhvillimin e suksesshëm siç janë procedurat e kontraktimit, fondet e krijuara me privatizim dhe pagesa e pjesës që u takon punëtorëve.

Raporti është përgatitur pas aktiviteteve kërkimore , anketimit në 100 ndërmarrje të privatizuara dhe 7 studimeve të rastit nga sektorët e ndryshëm. Përvojat nga vendet e tjera në tranzicion dëshmojnë se suksesi i procesit të privatizimit dhe performanca e ndërmarrjeve të privatizuara të shumtën varet nga mjedisi biznesor dhe korniza institucionale. Së këndejmi ky studim ka synuar që të trajtojë jo vetëm performancën e ndërmarrjeve tanimë të privatizuara por edhe ndikimet e mjedisit biznesor përkatësisht mënyrën se si ai shprehet tek ndërmarrjet privatizuara në krahasim me NVM tjera private. Për këtë qëllim anketa ka përfshirë mostren prej 600 ndërmarrjeve , prej të cilave 500 kanë qenë NVM të formuara si private 100 ndërmarrje të privatizuara nga shitja e NSH-ve. Kjo ka mundësuar që të krahasohen performancat e tyre dhe perceptimet e tyre mbi mjedisin biznesor . Metodologjia dhe teknikat e mostrimit janë zbatuar sipas standardeve tanimë të stabilizuara ne Riinvest. Me tepër detaje për këtë janë dhënë në Shtojcën 1. Studimet e rastit janë zhvilluar sipas një pyetësi të gjysmë strukturuar të pronarëve apo menaxherëve të ndërmarrjeve. Intervistat janë zhvilluar nga studentet e mastersit të Universitetit Riinvest nën udhëheqjen e hulumtuesve – ekipit kërkimor.

Në dëshirojmë të falënderojmë OSI –KFOS , Fondacionin Friedrich Ebert Stiftung dhe Ambasadën Holandeze për mbështetjen e këtij studimi dhe bashkëpunimin e frytshëm gjatë realizimit të tij. Ne gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë menaxheret, dhe pronaret e ndërmarrjeve për bashkëpunimin e tyre gjatë realizimit të këtij studimi . Duke falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar gjatë përgatitjes së këtij raporti megjithatë dëshirojmë të vejmë në pah se Riinvesti merr përgjegjësinë për konstatimet dhe rezultatet e këtij studimi.

## GJENDJA AKTUALE E PRIVATIZIMIT TE NSH-të E KOSOVES

Gjer me tani, procesi i privatizimit në Kosovë kishte fillim të vështirësuar të shoqëruar me hezitim dhe vonesa duke treguar përparime dhe ngecje në zhvillimin e tij. Që nga fillimi në qershor 2002, kanë ardhur në shprehje dy ndërprerje, e para gjatë kuartalit të katërt të 2003 dhe 2004 dhe më pas kishin rrjedhë të mirë gjatë vitit 2005, 2006 dhe para 2007, prapë se të ndërpritet prapë gjatë 2008. Me aktivizimin e bordit të AKP, procesi duhet të vazhdojë me përfshirje të NSH të pa privatizuara nga të cilat më të rëndësishme janë pjesët e Trepçës, Qendra skitare Brezovica, çështjet e pazgjidhura me NSH të Gjakovës. Shumica e NSH të mbetura pritet të vihen nën procedurat e likuidimit.

Procesi i privatizimit në Kosovë ka targetuar rreth 500 ndërmarrje shoqërore, nga të cilat pas luftës operonin vetëm 30 %, me 60,000 punëtorë. Nga ky numër i punëtorëve, vetëm 16,000 gjeneronin të ardhura. Në këto ndërmarrje gjatë viteve të 80-ta ishin të koncentruar asete të rëndësishme teknologjike dhe humane. Duke pasur parasysh qeverisjen e dhunshme nga Qeveria e Serbisë, vjetërsinë e asteve teknologjike dhe ndryshimet në mjedisin biznesor të tregut rajonal dhe ndërkombëtar, shumica e këtyre ndërmarrjeve kanë operuar në mënyrë joefektive dhe nën kapacitetet e tyre.

Me qëllim të institucionalizimit të procesit të privatizimit në Kosovë, administrata ndërkombëtare kishte krijuar kornizën ligjore speciale të përberë nga:

- Rregullorja për qeverisje dhe operacionet e AKM-së,
- Rregullorja mbi qeverisjen e përdorimit të tokës,
- Rregullorja mbi Odën Speciale në Gjyqin Suprem,
- Politikat operacionale të AKM-së,
- Rregullat e tenderimit dhe të procedurave

Në përgjithësi ky legjislacion ka aftësuar dhe lehtësuar shitjet direkte të ndërmarrjeve nëpërmjet spinn off-it të rregullt dhe special. Më vonë ky proces ishte shoqëruar me obligime investuese dhe të punësimit të bëra nga blerësit.

Pasqyra e implementimit të programit të privatizimit në Kosovë, tregon:

- Vlerësohet se rreth 300 NSH janë privatizuar apo likuiduar. Deri në qershor, 2008, 313 NSH janë tenderuar në formë të 551 kompanive të reja (New-Cos). Rreth 114 nga këto ndërmarrje të vjetra, tanimë janë në likuidim.
- Pesë vite pas fillimit të privatizimit, 393 nga këto kompani të reja janë në fazën e kompletimit të kontraktimit, se bashku me 24 me spin off special që kanë përfunduar kompletimin e kontraktimit. 78 kontratat për shitje të kompanive të reja do të kalojnë në AKP. (51 tenderët e kompanive të reja nuk e kanë arritur fazën e kompletimit).
- Mjetet e tërësishme nga privatizimi kapin shumën prej Euro 371 milion.
- Obligimet shtesë të investimeve për spin off special (vetëm 23 kompani) kapin shumën prej Euro 196 milion, përderisa mesatarja e investimeve për spin off special është 420.000 Euros për dy vitet e para,

- Obligimet për punësim për spinn off special janë 8,114 vende të punës.

Në përgjithësi, numri i total i kompanive të privatizuara që nga fillimi është 495 (10% ende presin kompletimin e kontraktimit). Këto kompani të reja janë krijuar nga asetet e 313 NSH-ve. AKM kishte përfunduar punën duke u transformuar në Agjencionin Kosovar të Privatizimit (AKP) i cili ka filluar se funksionuar që nga shtatori 2008.

Mjetet e akumuluar nga shitja e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore arrin në mbi €383 milion, apo rreth 11.5% të BPV-së. Megjithatë, këto mjete ende mbahen të ngrira nga ana e AKM dhe jashtë aktivitetit ekonomik të vendit.

Obligimet për investime nga spinn off-i special arrin në Euro 191.3 milion, ndërsa obligimet për punësim arrijnë në mbi 8,000 vende të punës.. Nëse realizohen të gjitha obligimet nga privatizimi (tenderët, likuidimi, shitjet dhe investimet) më shumë se gjysmë miliard Euro do të akumulohen nëpërmjet privatizimit. (KTA Management Information Summary, 2008)

# PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE EMPIRIKE MBI EFEKTET E PRIVATIZIMIT NË EKONOMITË NË TRANZICION

Në shkrime akademike privatizimi konsiderohet si përpjekje për të zëvendësuar vendimet hierarkike të ekonomisë së komanduar me nxitjet e prodhuesit që reagon në sinjalet e tregut për të maksimizuar fitimin (Harvylyshyn and McGettigan, 1999, p.3). Argumenti teorik i zakonshëm në favor të privatizimit ndaj pronësisë shoqërore është nxitja e pronarëve privatë për të përmirësuar performancën sepse këta vetë bartin përgjegjësitë financiare për veprimet e tyre. Frydman et al. (1997) ofrojnë një argument komplementar mbi superioritetin e firmave të privatizuara në kushte të tranzicionit. Sipas tyre, për shkak të pasigurisë në periudha tranzicioni, aftësitë efektive ndërmarrëse (të cilat nuk asocohen me pronësi shtetërore) bëhen relativisht më të rëndësishme për performancën e firmës. Përfundimisht, procesi i privatizimit rezulton me përmirësime të efikasitetit në nivel të firmës të cilat kur mbidhen së bashku ndikojnë në rritjen agregate.

Megjithatë studimet e ndryshme empirike përdorin metodologji të ndryshme, ato të gjitha synojnë të testojnë efektet e privatizimit në performancën e firmës (shih përmbledhjen nga Megginson dhe Netter, 2001). Megjithatë është shumë e vështirë të izolohen efektet e privatizimit në ekonomitë e tranzicionit për shkak se ky proces ndodhë njëkohësisht me ndryshime të tjera masive në ekonomi, studimet empirike ofrojnë bazë për konsensus në disa çështje të cilat i diskutojmë më poshtë.

Studimet e ndryshme gjatë viteve kanë dhënë rezultate të forta në favor të superioritetit të firmave të privatizuara duke u bazuar në kritere të performancës sic është produktiviteti, profitabiliteti, punësimi, investimet, eksportet, zhvillimi i produkteve të reja dhe gjetja e tregjeve të reja (shih, p.sh., Vining dhe Boardman, 1992; Megginson et al., 1994; Belka et al. 1995; Pohl et al., 1996; Djankov dhe Pohl 1998; etj.). Në nivel makroekonomik, rezultatet e Harvylyshyn et al. (1998) tregojnë se progresi në ristrukturim dhe privatizim, të matura me indikatorët përmbledhës të Bankës Evropiane për rindërtim dhe zhvillim (EBRD), kanë pasur ndikim pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në rritjen e bruto-produktit vendor (BPV) në 25 ekonomi tranzicioni në periudhën 1991-1997. Një konsensus tjetër që del nga studimet e performancës pas privatizimit është rëndësia e madhe e mjedisit të biznesit, i cili natyrisht është poaq i rëndësishëm për rritjen e sektorit privat në përgjithësi. Në këtë aspekt, Banka Botërore (1996) numëron stabilitetin ekonomik dhe politik, liberalizimin e tregut, sundimin e ligjit dhe uljen e krimit dhe të korrupsionit si faktorët të cilët promovojnë rritjen e sektorit privat dhe performancën e firmave të privatizuara.

## Dinosaurët apo firmat e reja

Një çështje tjetër më rëndësi që adresohet në literaturën e post-privatizimit është zgjedhja në mes të privatizimit dhe ndërmarrjeve të reja ose de novo si alternativë për rritje të pjesëmarrjes së sektorit privat. Në përgjithësi, studimet empirike tregojnë se performanca e ndërmarrjeve të privatizuara është diku në mes të sektorit de

novo privat dhe ndërmarrjeve shoqërore. Rezultatet e shumë studimeve empirike sugjerojnë se firmat e themeluara si private (de novo) kanë performancë më të mirë se firmat e privatizuara. Për shembull, rezultatet e Earle et al. (1996) sugjerojnë se dallimi në mes performancës së ndërmarrjeve shoqërore dhe atyre të privatizuara nuk është statistikiisht i rëndësishëm, ndërsa përforma e ndërmarrjeve de novo është më e mirë se ajo e ndërmarrjeve të privatizuara (dallimi është statistikiisht i rëndësishëm); prandaj autorët konkludojnë se qeveria duhet të bëjë përpjekje më të mëdha për të zhvilluar ndërmarrjet de novo të vogla dhe të mesme sesa për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore. Mirëpo, një ceshtje tjetër që shtrohet është nëse këto dy zhvillime janë komplementare apo për të arritur një të duhet sakrifikuar tjetrën. Në një të anë, privatizimi "liron" asetet që janë të bllokuara në ndërmarrjet shoqërore, gjë që ka efekte pozitive në sektorin privat. Në anën tjetër, Murrell (1992) mendon që kostoja e procesit të privatizimit është e lartë dhe burimet e përdorura në këtë proces mund të përdoren në mënyrë më të mirë për të zhvilluar një mjedis biznesi që promovon rritjen e sektorit privat. Harvlyshyn and McGettigan (1999) konkludojnë se megjithëse ndërmarrjet de novo janë superiore ndaj firmave të privatizuara, disa nga firmat e privatizuara mund të 'mësojnë trika të ri' dhe rëndësia e ndërmarrjeve shoqërore nuk duhet të hidhet poshtë në tërësi. Në fund, mund të argumentojnë se zhvillimi i firmave të privatizuara dhe sektorit de novo privat janë komplementarë sepse ky i fundit gjeneron mjedis konkurrues dhe bën presion konkurrues në firmat e privatizuara. Ky argument e vë në pah edhe një herë lehtësimin e kushteve për hyrje në treg për firmat de novo.

## Punësimi dhe menaxhimi para dhe pas privatizimit

Në socializëm një nga qëllimet e sektorit publik ka qenë që të ofrojë sa më shumë vende pune që është e mundur, prandaj ekzistonte tendenca që në ndërmarrjet shoqërore të kenë më shumë të punësuar se që është e nevojshme. Prandaj, mund të pritët që pas privatizimit të ketë përjashtime të punëtorëve nga firmat e privatizuara. Mirëpo, studimet empirike mbi punësimin pas privatizimit nuk japin rezultate të qarta. Rezultatet e shumicës së studimeve tregojnë që punësimi pas privatizimit ka rënë, mirëpo disa tregojnë që ka rritje (shih përmbledhjen nga Megginson and Netter, 2001). Përveç kësaj, Harper (2000) gjen se punësimi në Republikën Çeke ka rënë pas valës së parë të privatizimit në vitin 1992, por jo edhe pas valës së dytë në vitin 1994.

Një çeshtje tjetër që ngritet në literaturën e post-privatizimit është nëse ndërrimi i menaxherëve rezultoi me përmirësim të performancës së firmave. Shumica e studimeve empirike gjejnë se përforma përmirësohet në firmat ku angazhohen menaxherë të ri, në krahasim me firmat që vazhdojnë të menaxhohen nga stafi i njejtë sikur para privatizimit (shih përmbledhjen nga Megginson and Netter 2001). Një shpjegim i mundshëm për këtë që në sistemin socialist menaxherët ka të ngjarë të jenë zgjedhur për arsye që nuk kanë të bëjnë me aftësitë e tyre – arsye politike apo arsye të tjera. Një arsye tjetër mund të jetë që shumë nga menaxherët e mëparshëm nuk janë të gjendje të ndërrojnë sjelljet e tyre siç kërkojnë kushtet e tregut të ri dhe prandaj duhet të largohen në mënyrë që firma të përparojë.

## PERFORMANCA E KOMPANIVE TË PRIVATIZUARA NË KOSOVË

Në fillim paraqesim disa nga ndryshimet në performancën e kompanive të privatizuara nga viti 2006 deri në 2007 matur përmes indikatorëve të ndryshëm. Bazuar në rezultatet e anketës, qarkullimi mesatar i kompanive të privatizuara gati është dyfishuar nga viti 2006 në vitin 2007 (Tabela 4) përderisa vlera e eksportit është rritur për mbi 4 herë e gjysmë gjatë të njëjtës periudhë. Niveli i investimeve është rritur me rreth 30% përgjatë kësaj periudhe përderisa shfrytëzimi i kapaciteteve ka shënuar rënje të lehtë në 54%.

**Tabela 4: Indikatorët e preformancës së ndërmarrjeve të privatizuara**

Viti	Qarkullimi	Eksporti	Investimet	Shfrytëzimi i kapaciteteve
2006	21,360,424	2,852,100	38,574,915	57.4 %
2007	41,886,251	12,829,498	50,122,751	54.2%
Rritja në %	196.09%	449.83%	129.94%	-3.20%

### Përmbledhje statistikore e profilit të kompanive

Anketa është realizuar në prill të vitit 2008; mostra kë përfshirë 103 ndërmarrje të privatizuara (përfshirë 23 ndërmarrje të privatizuara me spin off special), prej të cilave vetëm 66 kanë qenë aktive gjatë kohës së anketimit (përfshirë gjitha ndërmarrjet e privatizuara me spin off special). Tabela 4.1 paraqet një përmbledhje statistikore të kompanive të privatizuara nga mostra jonë të cilat operojnë. Nga numri i përgjithshëm i kompanive aktive të privatizuara, 60% operojnë në sektorin prodhues; 21% në sektorin shërbyes ndërsa 19% të mbetura në sektorin e tregtisë. Ky diversifikim i mostrës na lejon që të analizojmë diferencat ndër-sektoriale.

Për sa i përket madhësisë<sup>6</sup>, 11% e kompanive janë mikro ndërmarrje, 50% janë të vogla, 35% janë të mesme ndërsa rreth 4.5% janë të mëdha. Paraprakisht kemi pritur që ndërmarrjet e privatizuara përmes spin off-it special të jenë ndërmarrje të mëdha mirëpo ne kemi vërejtur që ka ndërmarrje të privatizuar në këtë mënyrë që klasifikohen si ndërmarrje të vogla apo të mesme. Të gjitha ndërmarrjet e mëdha janë ndërmarrje të privatizuara përmes spin off-it special.

Për më tepër, ne hulumtuam llojet e ndërmarrjeve në bazë të pronësisë. Rezultatet tregojnë se gjysma e këtyre kompanive janë individuale prej të cilave 10 kompani janë të privatizuara përmes spin off-it special. 27% e ndërmarrjeve janë korporata prej të cilave 8 janë privatizuar përmes spin off-it special. Pjesa e mbetur e ndër-

<sup>6</sup> Madhësia e kompanisë përcaktohet nga numri i punëtorëve. Klasifikimi i ndërmarrjeve i bazuar në numri e punëtorëve: Mikro-Ndërmarrje: 1-9 punëtorë; Ndërmarrje e vogël: 10-49 punëtorë; Ndërmarrje e mesme: 50-249 punëtorë; Ndërmarrje e madhe: mbi 249 punëtorë.

marrjeve prej 23% janë ortakëri prej të cilave 5 ndërmarrje janë privatizuar përmes spin off-it special. Ndërsa, për sa I përket statutit ligjor, rreth 70% e ndërmarrjeve të privatizuara janë të regjistruara si kompani me përgjegjësi të kufizuar në mesin e të cilave 20 kompani të privatizuara përmes spin off-it special. Pjesa e mbetur prej 30% e ndërmarrjeve janë të regjistruara si kompani me përgjegjësi të pakufizuar në mesin e të cilave edhe vetëm 2 janë privatizuar përmes spin off-it special. Mund të vihet në përfundim se privatizimi ka stimuluar më shumë ortakëri dhe korporata krahasuar me sektorin tjetër privat të NVM-ve.

**Tabela 4.1: Përmbledhje statistikash të ndërmarrjeve të privatizuara të cilat operojnë**

<b>Sektori</b>	<b>%</b>	<b>Madhësia</b>	<b>%</b>	<b>Lloji i pronësisë</b>	<b>%</b>	<b>Statuti ligjor</b>	<b>%</b>
Sektori i prodhimit	59.1	Mikro ndërmarrjet	10.6	Biznese individuale	50	Kompani me përgjegjësi të pakufizuar	30
Sektori i tregtisë	19.7	Ndërmarrjet e vogla	50.00	Korporata	27	Kompani me përgjegjësi të kufizuar	70
Sektori i shërbimit	21.2	Ndërmarrjet e mesme	34.9	Ortakëri	23		
		Ndërmarrjet e mëdha	4.5				

## Kompanitë joaktive

Prej numri të përgjithshëm prej 103 ndërmarrjeve të privatizuara në mostër, 31% nuk funksiononin në kohën e anketimit. Kjo e dhënë është brengosëse duke pasur parasysh faktin se këto ndërmarrje janë privatizuar para muajit mars të vitit 2007, gjë që u lë atyre kohë më shumë se 13 muaj për marrë kontrollin mbi ndërmarrjen dhe për të konsoliduar afarizmin. Nga këto kompani, 25% janë nga sektori i tregtisë dhe 22 nga sektori i prodhimit; 17% janë toka dhe kooperativa bujqësore; 11% janë hotele dhe restorante; 6% janë në sektorin e shërbimeve dhe pjesa e mbetur prej 19% janë ndërtesa administrative dhe depo. Nga këto kompani, 30% janë nga rajoni i Pejës; 48% janë nga rajonet e Mitrovicës dhe Gjakovës (me nga 24% secila); 18% nga rajonet e Gjilanit dhe Prizrenit (me nga 9% secila); dhe vetëm 3% nga rajoni i Prishtinës.

Duhet të theksohet që asnjë nga kompanitë që nuk funksionojnë janë privatizuar përmes spin off-it special. Tabela 4.2 paraqet në mënyrë të përmbledhur të dhënat e kompanive të privatizuara të cilat janë ende joaktive.



**Tabela 4.2: Përmbledhje statistikash të ndërmarrjeve të privatizuara të cilat nuk operojnë**

<b>Sektori</b>	<b>%</b>	<b>Regjioni</b>	<b>%</b>
Sektori i tregtisë	25	Prishtina	3%
Sektori i prodhimit	22	Prizreni	9%
Toka dhe kooperativa bujqësore	17	Peja	30%
Hotele dhe restorante	11	Mitrovica	24%
Sektori i shërbimit	6	Gjakova	24%
Ndërtesa administrative dhe depo	19	Gjilani	9%

Arsyeja pse një e treta e ndërmarrjeve të privatizuara nuk operojnë dallon nga rasti në rast. Në disa raste, pronarët nuk kanë mundësi të bëjnë investime shtesë si dhe kapital shtesë të domosdoshme për operacionalizimin e ndërmarrjes së tyre. Arsye tjetër mund të jetë fakti që disa nga pronarët e ri të ndërmarrjeve i shohin këto investime si investime në patundshmëri dhe presin një moment më të mirë kapitalizimi në treg. Ne nuk kemi mundur të hulumtojmë më thellë në këtë çështje pasi që është shumë e vështirë të kontaktohen pronarët e rinj.

## Qarkullimi

Përvojat tona të mëparshme me anketa kanë sugjeruar se niveli i qarkullimit është e dhënë e ndjeshme të cilën menaxherët hezitojnë të raportojnë; apo të paktën ta raportojnë ndershëm. Ky problem është edhe më i madh në vende si Kosova ku konsiderohet se një pjesë e madhe e ekonomisë realizohet në sektorin jo-formal. Si rrjedhojë, me shpresë që të ngrisim nivelin e përgjigjeve dhe të minimizojmë tendencën për të nënvlerësuar qarkullimin, nga kompanitë është kërkuar që të specifikojnë intervalin e qarkullimit të cilit i takojnë e jo të specifikojnë shumën e saktë.

Niveli mesatar i qarkullimit të ndërmarrjeve nga mostra për vitin 2007 është €101,250 sidoqoftë, siç edhe është pritur, ai ndryshon varësisht nga madhësia e kompanisë. Kur kjo shifër krahasohet me kompanitë tjera të sektorit privat (NVM), del se kompanitë e privatizuara kanë qarkullim më të vogël statistikisht domethënës (Tabela 4.3.1). Qarkullimi mesatar në kompanitë e privatizuara është për 70, 129 dhe 20 përqind më e vogël për kompanitë mikro, të vogla dhe të mesme respektivisht. Kjo pjesërisht mund të jetë për shkak se kompanitë e privatizuara, mesatarisht, kanë hyrë në treg më vonë dhe si rrjedhojë kanë përvojë më të vogël dhe nuk kanë krijuar reputacion në treg.

**Tabela 4.3.1: Qarkullimi mesatar mujor i kompanive të privatizuara dhe atyre të private në bazë të madhësisë (2007)**

Madhësia e ndërmarrjes	Vlera mesatare e qarkullimit	
	Kompanitë e privatizuara	Kompanitë tjera
Mikro	4,166	7,105
Të vogla	36,048	82,445
Të mesme	177,159	211,346

Siç është pritur, performanca e kompanive dallon edhe në bazë të metodës së përdorur për privatizim; ku kompanitë e privatizuara përmes spin off-it special kanë qarkullimin më të lartë mujor (Tabela 4.3.2). Sidoqoftë, në mënyrë që të gjejmë se cilat kompani performojnë më mirë, ne duhet kalkuluar produktivitetin për punëtor<sup>7</sup>. Duke bërë një gjë të tillë, ne vërejmë se, në mesatare, kompanitë e privatizuara përmes spin off-it të rregullt kanë qarkullimin më të lartë për një punëtorë, përderisa kompanitë e privatizuara përmes likuidimit kanë performancën e dytë më të mirë. Çuditërisht, kompanitë që janë privatizuar përmes spin off-it special kanë produktivitetin për punëtorë më të ulët. Sidoqoftë, mund të argumentohet se kjo është shkaktuar nga numri i tepërt i punëtorëve që këto kompani kanë, edhe pse mund të mos ju duhen, por që janë të obliguar me dispozitat e kontratës së spin off-it special.

**Tabela 4.3.2: Qarkullimi mesatar mujor i kompanive të privatizuara në bazë të metodës së privatizimit(2007)**

Metoda e privatizimit	Qarkullimi	Produktiviteti për punëtorë (Qarkullimi/Numri i punëtorëve)
Spin-off special	224,048	707
Spin-off i rregullt	43,182	1,270
Likuidim	38,056	969

Në mënyrë që të analizojmë zhvillimet përgjatë vitit të fundit dhe pritjeve për vitin e ardhshëm, menaxherët e kompanive janë pyetur që të vlerësojnë gjendjen e përgjithshme të afarizmit të tyre dhe fitimin në këtë vit krahasuar me vitin para-prak. Rezultatet sugjerojnë se rreth 84% e kompanive të privatizuara presin performancë më të mirë këtë vit krahasuar me vitin 2007 dhe kjo paraqet një vijimësi nga viti 2006 (Tabela 4.3.3). Kjo përqindje është ndjeshëm më e ulët për ndërmarrjet tjera të sektorit privat gjë që mund të sugjeroj se kompanitë e privatizuara po performojnë më mirë se pjesa tjetër e sektorit privat. Megjithatë, një sqarim më i pranueshëm i këtyre rezultateve do të ishte që këto kompani janë më të reja dhe rriten me hap më të shpejtë pasi që nisen nga një bazë më e ulët. Në fakt, për më shumë se gjysmën e kompanive të anketuara, viti 2006 ka qenë viti i parë që kanë filluar aktivitetin e tyre pas privatizimit. Është shumë inkurajuese të shihet se kompanitë e privatizuara, edhe pse fillojnë nga një bazë më e ulët, po rriten më shpejtë dhe shumë shpejtë mund ta zënë hapin me pjesën tjetër të sektorit privat.

7 Produktiviteti për punëtorë kalkullohet duke pjestuar qarkullimin me numër të punëtorëve.

**Tabela 4.3.3: Afarizmi dhe fitimi në vitin 2007 krahasuar me vitin 2006**

	Fitimi		Gjendja e përgjithshme e afarizmit	
	Kompanitë e privatizuara	Kompanitë tjera	Kompanitë e privatizuara	Kompanitë tjera
Më mirë	56%	32%	61%	38%
Pa ndryshim	27%	30%	23%	23%
Më keq	17%	37%	16%	39%
Total	100%	100%	100%	100%

## Punësimi

Numri i të punësuarve është një tjetër indikator i performancës i përdorur në këtë studim. Ky indikator paraqet rritjen e përafërt të firmave; për më tepër duke pasur parasysh faktin se ndërmarrjet nuk hezitojnë ta raportojnë ndershem këtë numër krahasuar me qarkullimin apo fitimin. Numri mesatar i punëtorëve në mostrën e ndërmarrjeve të privatizuara në vitin 2007 është 125.8, afërsisht dhjetë herë më i lartë se ai i NVM-ve. Kjo është e kuptueshme kur kemi parasysh se mostra përmban edhe ndërmarrje të mëdha. Për më tepër, firmat e privatizuara ka mundësi të kenë trashëguar një numër të madh punëtorësh se sa do të merrnin në rrethana tjera. Së këndejmi krahasimi në bazë të numrit mesatar të punëtorëve nuk pasqyron në mënyrë reale performancën e grupeve të ndryshme të kompanive. Sidoqoftë, ne mund të krahasojmë nivelin e rritjes së punëtorëve gjatë vitit 2007 tek të dy llojet e ndërmarrjeve. Bazuar në vlerësimet e bëra nga menaxherët, ky indikator sugjeron se kompanitë e privatizuara, në mesatare, janë rritur më shpejtë krahasuar me pjesën tjetër të sektorit privat (Tabela 4.4.1). Gjatë vitit 2007 punësimi tek ndërmarrjet e privatizuara është rritur për 9.7% - gati dyfishi i rritjes në pjesën tjetër të sektorit privat.

**Table 4.4.1: Rritja e punësimit në ndërmarrjet private dhe ato të privatizuara**

	Numri mesatar i punëtorëve		%
	Dhjetor-06	Dhjetor-07	
Ndërmarrjet e privatizuara	114.6	125.8	9.7
NVM-të private	4.3	4.5	5.0

Përderisa nuk mund të nxjerrim një rezultat përfundimtar lidhur me punësimin në kompanitë e privatizuar krahasuar me periudhën para privatizimit, duket se niveli i punësimit mesatarisht ka rënë. Rezultatet e anketës tonë me ndërmarrjet e privatizuara që funksionojnë sugjeron se numri i të punësuarve është ulur për

vetëm 10% mirëpo duhet cekur se këto rezultate janë bazuar vetëm në përgjigjet e gjysmës së ndërmarrjeve dhe si e tillë mund të konsiderohet si indikacion. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve aktualisht, 60% kanë punuar edhe para privatizimit. Megjithatë, një konkludim logjik do të ishte që punësimi përgjithësisht ka rënë edhe më tepër pasi që kompanitë që kanë ofruar të dhëna lidhur me numrin e të punësuarve para privatizimit janë kryesisht ato që kanë mbajtur punëtorët e mëparshëm. Ky sqarim mbështet nga e dhëna se kompanitë e njëjta që kanë ofruar këto të dhëna kanë qenë kryesisht ato që kanë pasur të dhëna edhe për proporcionin (pjesëmarrjen) e punëtorëve të mëparshëm që ata kanë mbajtur. Për më tepër, ne duhet konsideruar edhe numrin e ndërmarrjeve që nuk punojnë si dhe ndikimin e tyre negative në punësim. Mirëpo, me fillimin e punës së këtyre kompanive dhe rritjes së investimeve dhe qarkullimit, do të rritet edhe punësimi siç është përvoja me kompanitë aktive gjatë vitit 2006 dhe 2007.

Për sa i përket nivelit të arsimit, ne shohim se kompanitë e privatizuara kanë një strukturë pak më të mirë kualifikuese të punëtorëve krahasuar me pjesën tjetër të sektorit privat (Tabela 4.4.2). Shumica e strukturës menaxhuese të kompanive të privatizuara kanë shkollim superior<sup>8</sup> dhe strukturë më të mirë kualifikuese krahasuar me pjesën tjetër të sektorit privat. Rezultatet e anketës gjithashtu tregojnë se këto kompani i kushtojnë më shumë rëndësi nevojës për trajnim si për stafin menaxhues ashtu edhe për punëtorët.

**Tabela 4.4.2: Niveli i arsimimit të strukturave menaxheriale në kompanitë e privatizuara krahasuar me kompanitë private.**

Përshkrimi	Niveli i arsimimit			
	Superior	I lartë	I mesëm	Fillorë
Menaxhmenti i kompanive të privatizuara	56.43	36.93	6.63	0
Menaxhmenti i kompanive tjera private	30.43	45.90	23.35	0.35

## EKSPORTET

Anketa e ndërmarrjeve të post-privatizuara tregon se edhe pse 60% e tyre janë të regjistruara për aktivitete eksportuese, vetëm 29% kanë pasur eksport gjatë vitit 2007 (krahasuar me 10% në NVM-ve që kishin eksport në po të njëjtin vit). Thënë këtë në vlera monetare, vlera mesatare e eksporteve për çdo ndërmarrje është 1.1 milion euro, apo 35% e qarkullimit vjetor të tyre. Efektet e kompanive të privatizuara në eksporte kanë qenë mjaft të dukshme gjatë dy viteve të fundit, ku vlera e eksporteve është dyfishuar.

Rreth 65% e produkteve të eksportuara janë produkte të gatshme ndërkaq pjesa e mbetur është lëndë e parë. Struktura e produkteve të eksportuara jepet në tabelën 4.5.1

<sup>8</sup> Shkollimi superiorë nënkupton arsimimin universitar apo më të lartë.

**Tabela 4.5.1. Struktura e eksporteve**

Llojet e eksporteve	Post-Privatizuara	NVM-tës
Produkte të gatshme	64.6%	70.5%
Lëndë e parë	35.4%	22.7%
Shërbime	0%	6.8%
<b>TOTAL</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Ndërmarrjet më të mëdha eksportuese në vitin 2007 ishin Lamkos dhe Qyqavica nga Vushtrria me 10 dhe 7.1 milion euro respektivisht, të përcjellura nga Feronikli me 1 milion euro, Fan Podujevë me 1 milion euro, Peja Wood me rreth 600.000 euro. Vlera e përafërt e eksporteve të ndërmarrjeve më të mëdha eksportuese, si dhe destinacioni i tyre për vitin 2007 janë dhënë në Tabelën 4.5.2.

**Tabela 4.5.2. Vlera e destinacionit të eksporteve të ndërmarrjeve të selektuara**

Ndërmarrja	Vlera në Euro	Vendet
Lamkos	10,000,000	Serbi, Shqipëri, Mal i Zi, Bosnje dhe Rumani
Qyqavica	7,100,000	Maqedoni, Austri, Rumani, Kroaci dhe Shqipëri
Feronikel	1,000,000	Indi, Kinë, Belgjikë, Skandinavi
Fan Podujevë	1,000,000	Kroaci, Serbi, Shqipëri
Peja Wood	680,000	Gjermani, Maqedoni, Shqipëri, Bosnje, Mal i Zi

Vendet në të cilat këto ndërmarrje eksportojnë janë vendet e rajonit, të Evropës Qendrore si dhe në disa vende aziatike. Eksporti total i ndërmarrjeve të privatizuara ka qenë 22.792.750 euro në vitin 2007. Kjo është rreth 15% e eksporteve totale të Kosovës. Megjithatë duhet theksuar se niveli i importeve nga këto ndërmarrje ka qenë rreth 49.863.592 euro. Megjithatë eksportet e kompanive të privatizuara i mbulojnë importet me 46% që është mjaft më e lartë se mesatarja për ekonominë e Kosovës që arrin rreth 12%.



## RISTRUKTURIMI I NDËRMARRJEVE

Termi ristrukturimi i ndërmarrjeve përfshinë tërë procesin e bërë nga ndërmarrjet drejt adoptimit të sjelljeve të tyre për të mbijetuar dhe për të pasur sukses në ekonomi të tregut. Opinioni gjeneral është se procesi i privatizimit ka qenë i asociuar me ristrukturimin e mëparshëm të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-të) dhe që ka rezultuar në përmirësime të efikasitetit, produktivitetit, profitabilitetit, inovacionit dhe nivelit të investime në NSH-të.

Për të përcaktuar nivelin e ristrukturimit në kompanitë e privatizuara ne kemi konsideruar fillimisht faktorë të ndryshëm, hapat e ristrukturimit të ndërmarrja pas privatizimit dhe më pas masat e adoptuara vitin e fundit. Tabela 5.1. bën një përmbledhje të rezultateve.

Fillimisht, ne kemi hulumtuar se a kanë bërë NewCos lancimin e produkteve të reja apo kanë filluar me metodë të re të prodhimit pas privatizimit. Është vërejtur se, në përgjithësi, -33.33 % kanë lancuar produkte të reja deri sa pjesa tjetër e kompanive kanë vazhduar të prodhojnë produkte të njëjta si më parë. Nëse marrim parasysh metodën e përdorur të privatizimit, kuptojmë se mbi 45% e spin off-ëve special kanë filluar me produkte të reja dhe, siç ishte pritur, kjo shifër është më e lartë se spin off-ët e rregullt (30.30 %) apo nëpërmjet likuidimit (22.22%). Për më tepër, rreth 44% e kompanive të privatizuara kanë lancuar metoda të reja të prodhimit derisa të tjerat kanë vazhduar të prodhojnë me makineri të njëjtë dhe me metoda të njëjta. Nëse e ndajmë edhe më tutje këtë numër shohim se më tepër se gjysma e kompanive të privatizuara nëpërmjet spin off-it special kanë lancuar metoda të reja të prodhimit. Kjo është pak më e lartë se kompanitë e privatizuara me spin off të rregullt (45.45%) apo nëpërmjet likuidimit (22.22%). Nëse i marrim parasysh tërë këto rezultate, shohim se disa kompani të privatizuara kanë filluar me prodhimin e produkteve të reja duke përdorur metoda dhe makineri të para-privatizimit.

**Tabela 5.1: Hapat e restrukturimit pas privatizimit**

Metoda e privatizimit	Kanë filluar prodhimin e produkteve të reja		Kanë filluar me metodë të re të prodhimit	
	Po	Jo	Po	Jo
TOTAL	33.33%	63.64%	43.94%	37.00
Spin off special	45.45%	54.55%	45.45%	12.00
Spin off i rregullt	30.30%	69.70%	51.52%	18.00
Likuidimi	22.22%	77.78%	22.22%	7.00

Më pas, siç përshkruhet në pjesën e mëposhtme të këtij seksioni ne kemi hulumtuar hapat restrukturues të këtyre kompanive në vitin e fundit. Menaxherët dhe pronarët në përgjithësi kanë pranuar faktin se ristrukturimi është një hap më se i nevojshëm

për suksesin e kompanive në ekonomi të tregut. Siç mund të shihet nga Tabela 5.2 pothuajse gjysma e kompanive tani prodhojnë me metoda të reja të prodhimit dhe rreth 75% kanë përmirësuar metodat ekzistuese të prodhimit. Këto rezultate tregojnë shenja inkurajuese të përpjekjeve restrukturuese nga kompanitë e privatizuara. Më tej shohim se vetëm 13.7% e kompanive kanë mbyllur linjat ekzistuese të prodhimit. Ky numër, i përcjellur nga të mëparshmit, tregon se shumica e kompanive operojnë me makineri dhe metodologji të kombinuar se sa ti mbyllin ato të gjitha. Rrjedhimisht vetëm një pjesë e proporcionit të këtyre kompanive (24.2 %) kanë ofruar produkte/shërbime inovative në treg.

**Tabela 5.2: Masat restrukturuese të ndërmarra nga ndërmarrjet e privatizuara gjatë vitit të fundit**

Adoptimi i metodave të reja të prodhimit		Përmirësimi i metodave ekzistuese të prodhimit		Mbyllja e linjave ekzistuese të prodhimit		Inovacione (kanë filluar me prodhime / shërbime të reja në treg)	
Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo
47.5%	52.5%	74.8%	25.2	13.7	83.3	24.2	65.2

Ky hulumtim gjithashtu ka përcjellë strukturën menaxhuese të këtyre kompanive. Shihet se shumica e kompanive të privatizuara ende menaxhohen nga pronarët e tyre. Vetëm 6% të kompanive menaxhohen nga menaxherët, deri sa të tjerat menaxhohen nga forma tjera e të përziera të menaxhmentit. Si rrjedhojë, nëse ky segment mund të përmirësohej, atëherë do të iniciante një ristrukturim më të mirë dhe rrjedhimisht performancë më të mirë.

Ne kemi konsideruar edhe ndikimin e pronësisë meqë shihet si faktor i madh influencues në ristrukturim (Djankov and Murrel, 2002). Sipas anketës sonë 13% e kompanive janë privatizuar duke i përfshirë pronarët e huaj (Tabela 6.1). Literatura nga vendet tjera të tranzicionit sugjeron se pronësia e huaj sjell ristrukturim më të mirë dhe më të shpejtë. Për më tepër, shumica e kompanive të blera nga investitorët e huaj në Kosovë janë privatizuar nëpërmjet metodës së spin off-it special. Përkundrazi përkushtimit të tyre në kushte të investimeve dhe punësimit, këto kompani konsiderohen të jenë më profitabile se të tjerat. Kjo rrjedhimisht kërkon dhe mbështetë ristrukturim më të shpejtë.

Në përgjithësi, rezultatet tona japin evidencë se kompanitë që bëjnë ristrukturimin dhe e konsiderojnë atë si parakusht për performancë më të mirë. Megjithatë përmasat e këtyre hapave kanë nevojë për përmirësime të mëtutjeshme dhe të vazhdueshme.



## FINANCIMI DHE INVESTIMET NË KOMPANITË E PRIVATIZUARA

Sipas gjetjeve të anketës 89% e ndërmarrjeve synojnë të investojnë dhe vlera mesatare e investimeve të planifikuara është 1.8 milion Euro. Këto investime kanë për qëllim të rrisin shitjet në tregun vendor (53%) derisa 44% do të targetojnë tregjet e huaja. Volumi i investimeve në kompanitë e privatizuara është shumë më i lartë se në sektorin privat. Në vitin 2007 volumi mesatar i investimeve në kompanitë e privatizuara është pothuajse trefishuar ( nga 1,347,811 më 2006 në €4,338,274 më 2007). Është me rëndësi të hulumtohet burimet e fondeve për të financuar këto aktivitete investive, si dhe të gjitha të tjerat të përdorura për financimin e privatizimit.

Gjetjet janë dhënë në Tabelën 6.1 duke treguar se shumica e investimeve janë financuar nga fondet vetanake për ndërmarrjet e privatizuara dhe ndërmarrjet de-novo. Megjithatë, një dallim i rëndësishëm është vërejtur në drejtim të pjesës tjetër të financimit. Për shembull, pjesëmarrja e fondeve vetanake në investimet totale është shumë më e lartë në firmat tjera private se sa në firmat e privatizuara. Në anën tjetër pjesëmarrja e kredive bankare për të financuar investimet është shumë më e madhe në kompanitë e privatizuara se sa në ndërmarrjet tjera private, për bankat vendore dhe të huaja. Kjo gjetje konfirmon rëndësinë më të madhe të financimit bankar në për ndërmarrjet që marrin pjesë në procesin e privatizimit. Një dallim tjetër është vërejtur në termat e kapitalit të huaj apo investimeve të jashtme direkte. Siç jepet në Tabelën 6.1, pjesëmarrja e kapitalit të huaj është 13% për kompanitë e privatizuara dhe vetëm një pjesë e vogël për firmat tjera private (0.18%). Në mesin e ndërmarrjeve të financuara me kapital të huaj, 28.8 % (8 investitorë) janë nga diaspora kosovare.

Kjo mund të indikojë se privatizimi në Kosovë ka qenë relativisht më atraktiv për kapitalin e huaj krahasuar me investimet në kompanitë e tjera private. Sidoqoftë, kjo duhet të analizohet në bazë të vlerës së investimeve se sa në bazë të numrit të ndërmarrjeve pasi që janë vetëm dy ndërmarrje që janë privatizuar vetëm nga investitorë të huaj.

**Tabela 6.1. Burimet e investimeve ne kompanitë e privatizuara dhe në kompanitë tjera private (in %)**

Burimet	Të privatizuara		kompanitë tjera private
	Burimet e fondeve për privatizim	Burimet e fondeve për investime pas privatizimit	
Burime vetanake	52.16	63.9	83.07
Kredi nga bankat vendore	28.54	21.3	15.21
Kredi nga bankat të huaja	2.24	5.2	0.48
Huazim nga miqtë dhe familja	1.05	5.9	1.04
Investime të jashtme direkte (IJD)	13.01	3.7	0.18
Burime tjera	2.99	0.0	0.02
Total	100.00	100.0	100.00

Një dallim interesant për tu theksuar i përket burimeve të fondeve për periudhën e privatizimit dhe post-privatizimit. Ky dallim është reflektuar në kushte të rrolit të investimeve të jashtme direkte dhe bankave vendore. Këto dy resurse kanë luajtur shumë rol më të madh në dhënien e fondeve për qëllime të privatizimit (blerja e asetëve të NSH-ve) krahasuar me fondet e dedikuara për investimet në periudhën e post privatizimit (ristrukturimi dhe revitalizimi).

Jo vetëm qasja në financimin bankar por gjithashtu edhe kushtet për pagesën e kredive luajnë një rol të rëndësishëm në ekspansionin e ndërmarrjeve. Nga numri total i ndërmarrjeve të privatizuara që kanë përdorur kredinë bankare (58%) shumica prej tyre (81%) kanë deklaruar që kushtet e kredisë kanë qenë të pafavorshme dhe kundër tendencave të rritjes së tyre. Asnjëra nga ndërmarrjet që përdorin kreditë bankare nuk kanë menduar që kushtet e kredive janë të favorshme. Periudha mesatare e pagesës për kredi është rreth 3 vite për ndërmarrjet "tjera private" duke sugjeruar kështu faktin se ndërmarrjet e involvuara në projektet afat-gjata do të ballafaqohen me vështirësi në gjetjen e kredive afat-gjata.

Këto gjetje indikojnë se krahas politikave që fasilitojnë qasjen e ndërmarrjeve në kredi bankare, politika të tjera duhet të targetohen drejt përmirësimit të kushteve për kredi (norma të interesit, grace-periudha, etj). Për shembull, nga 42 kompani të privatizuara që kanë kërkuar kredi bankare vetë 4 janë refuzuar; dy kompani nuk kanë aplikuar për shkak të kushteve të pafavorshme. Kjo ilustron brengën më të madhe rreth kushteve të kreditimit krahasuar me qasjen për kredi.

Edhe pse metodat e spin-off-it special të privatizimit është aplikuar për të siguruar investimet e nevojshme për sektorë specifik, gjetjet e anketave tregojnë vështirësi në arritjen e objektivave të vëna nga AKM-ja. Vetëm 39% e ndërmarrjeve të privatizuara me spin-off special i kanë arritur investimet dhe numrin e punëtorëve të specifikuar në kontratat e tyre me AKM-në. Ndërsa vetëm kriteri i vënë nga agjencioni i privatizimit lidhur me investimet është plotësuar nga 51% e ndërmarrjeve. Arsyet për këtë diskrepancë në arritjen e objektivave të investimeve kanë nevojë për hulumtim të mëtutjeshëm. Megjithatë, disa prej arsyeve që mund të shpjegojnë pjesërisht dështimin drejt arritjes së objektivave të investimeve janë: vonesat në nënshkrimin e kontratave pasi që kompanitë janë blerë dhe marrë nën kontroll nga pronarët (zakonisht 9-12 muaj), dështimi i AKM-së për të monitoruar si duhet kompanitë e privatizuara; si dhe fakti që rreth 15% e kompanive të privatizuara u janë shitur blerësve të dytë dhe procesi është komplikuar më shumë.

# PERCEPTIMI I MJEDISIT BIZNESOR

## BARRIERAT NË ZHVILLIMIN E BIZNESIT

Tabela 7.1 më poshtë paraqet perceptimet e respondentëve nga bizneset e privatizuara lidhur me barrierat e ndryshme për zhvillimin e biznesit. Intenziteti i barrierave matet me pika prej zero e deri në 100. Do të ishte e dobishme nga perspektiva politike për shqyrtimin e ndryshimeve ndërmjet barrierave të përjetuara nga bizneset e privatizuara dhe nga firmat e tjera, sidomos nëse aplikohen politikat selektive.

Perceptimet e ndërmarrësve që zotërojnë biznese të privatizuara dallojnë deri në një masë nga perceptimet e atyre ndërmarrësve që zotërojnë biznese të tjera. Megjithatë këto dallime nuk janë edhe aq të rëndësishme. Renditja e pikave është e ngjashme mirëpo intensiteti i barrierave si niveli i ulët i furnizimit të energjisë elektrike, si niveli i ekonomisë joformale, vështirësitë në komunikim, korrupsioni dhe shërbimet e tjera publike janë më të mëdha në firmat e tjera private sesa në kompanitë e Privatizuara. Barrierat me një renditje më të lartë në kompanitë e post-privatizimit janë taksat e larta dhe qasja në kredi.

**Table 7.1a: Intensiteti i barrierave për kompanitë e Privatizuara dhe kompanitë e tjera Private)**

	Kompanitë e Privatizuara	Kompanitë e tjera Private
Furnizimi i ulët i energjisë elektrike	76.1	82.8
Taksat e larta	74.6	68.4
Ekonomia Joformale	70.2	75.9
Shërbimet Publike	66.9	74.0
Infrastruktura e varfër e rrugës dhe telekomunikacionit	67.8	72.1
Korrupsioni	61.3	70.6
Qasja në Financa	63.3	49.8

Njoftim: Niveli i 'Intensitetit të Barrierave' renditet prej 0 e deri në 100.

Vlen të thuhet se taksat e larta dhe qasja në financa janë më të dëmshme për bizneset e privatizuara. Një sqarim i mundshëm është se bizneset e privatizuara janë më të reja sesa bizneset e tjera private, prandaj bizneset e privatizuara edhe ballafaqohen me pengesa që ballafaqohen ndërmarrjet e reja. Gjithashtu ndërmarrësit që kanë biznese të privatizuara kanë investuar shuma të rëndësishme të kapitalit financiar gjatë procesit të privatizimit, kështu që çdo ngarkesë financiare e më tutjeshme që përjetojnë bizneset e privatizuara, paraqet barrë shtesë që është vështirë të tejkalohet. Gjithashtu, bankat mund të hezitojnë që të financojnë bizneset e sapo formuara, sidomos bizneset e privatizuara që mund të ballafaqohen me probleme të rrjedhjes së parasë si pasojë e investimeve të mëdha në fazën fillestare të këtyre bizneseve.

## Konkurrenca

Sa i përket konkurrencës, rezultatet tregojnë që intensiteti i konkurrencës nga konkurrenca vendore dhe importi është më i ashpër në sektorin e 'kompanive të tjera private', ku mbi 38 % të kompanive konsiderojnë konkurrencën vendore si pengesë shumë e madhe, ndërsa vetëm rreth 24 % të kompanive të post-privatizuara e konsiderojnë konkurrencën vendore si pengesë shumë të madhe. Gjithashtu ja vlen të përmendët fakti se mbi 20 % të kompanive të sektorit privat, në krahasim me vetëm 12 % të kompanive të post-privatizuara konsiderojnë konkurrencën nga importi si pengesë shumë të madhe për zhvillimin e kompanive të tyre. Shumica e kompanive që ju takojnë këtyre dy sektorëve, nuk e shohin aspak si pengesë konkurrencën që vjen nga vendi dhe nga importi.

Një dallim tjetër të rëndësishëm që këto dy grupe kanë sa i përket konkurrencës, është se bizneset e privatizuara ballafaqohen me një konkurrencë më të vogël në krahasim me bizneset e tjera private. Kjo sqarohet nga disa tregues. Në bazë të numrit të punëtorëve, qarkullimit dhe asetëve, bizneset e privatizuara janë më të mëdha se sa firmat e tjera.

Kjo u jep atyre një përparësi sepse ato përfitojnë nga prodhimi me shumicë. Gjithashtu 60 % e bizneseve të privatizuara janë të orientuara nga eksporti (në krahasim me 20 % të firmave të tjera private) duke theksuar aftësitë konkurruese të tyre në depërtimin në tregjet e huaja, dhe duke u varur sa më pak në kërkesat lokale. Për më tepër, bizneset e privatizuara investojnë kapital shumë më të madh sesa firmat e tjera (4,338,274 Euro për bizneset e privatizuara, ndërsa 331,610 Euro për bizneset e tjera private), duke theksuar seriozitetin e tyre në aktivitetet biznesore. Duke pas parasysh këta indikatorë, është shumë e qartë se bizneset e privatizuara janë më konkurruese në treg, prandaj edhe hasin në një konkurrencë më të vogël në krahasim me firmat e tjera private.

## KORRUPSIONI

Nëse supozojmë se procesi i privatizimit në Kosovë ka qenë transparent dhe i hapur për të gjithë, metoda e përdorur (sidomos metoda e spin off-it të rregullt) ka lënë më pak hapësirë për korrupsion, sepse kjo ka zvogëluar lirinë e veprimit për institucionet e përfshira në këtë proces. Kjo metodë ka zvogëluar elementet subjektive të metodave të tjera të privatizimit. Megjithatë duke u bazuar në rezultatet e anketës sonë të prezantuar në tabelën 7.3.1, rezultatet e anketës tregojnë se gjysma e respondentëve nga kompanitë e privatizuara perceptojnë se korrupsioni është shumë i përhapur, përderisa 31.8 % e perceptojnë se korrupsioni është i përhapur, ndërsa vetëm 3 % e respondentëve perceptojnë se nuk ka korrupsion fare. Këto rezultate në të kundërtën e vejnë në pikëpyetje transparencën e procesit të privatizimit, pa marrë parasysh metodën e privatizimit duke njohur faktin që perceptimi se korrupsioni është shumë i përhapur ndikohet nga mungesa e transparencës. Sa i përket korrupsionit perceptimet e pronarëve të bizneseve të privatizuara janë të ngjashme me kompanitë private të ashtuquajtura de-novo duke reflektuar një ilustrim më të besueshëm për nivelin e korrupsionit në Kosovë (Tabela 1, Kolona e Tretë).

**Tabela 7.3.1 Perceptimi i respondentëve në nivelin e korrupsionit në Kosovë (%)**

Mbizotërimi i korrupsionit në Kosovë	Kompanitë e Privatizuara	Kompanitë e tjera Private
Përhapje shumë e madhe	50.0	59.6
Përhapje	31.8	24.4
Përhapje mesatare	9.1	9.8
Përhapje e rrallë	1.5	1.8
Nuk përhapet	3.0	0.6
Pa përgjigje	4.5	3.9
<b>Totali</b>	<b>100.0</b>	<b>100</b>

Për më tepër, hulumtimi i ndërmarrë për të kërkuar opinionin e ndërmarrësve për nivelin e korrupsionit në institucione të ndryshme. Intensiteti i rezultatit për nivelin e korrupsionit në institucione të ndryshme varet prej zero e deri në 100. Sipas këtyre perceptimeve, korrupsioni është më së shumti i përhapur në institucionet e shërbimeve shëndetësore (Tabela 7.3.2), të cilat janë jashtë sferës së këtij studimi. Ata janë të përcjellur nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) me një intensitet prej 82.1. Duke ditur që këto kompani u janë dhënë nën besim AKM-së e pastaj ato janë privatizuar nga vetë AKM-ja, atëherë këto shifra kanë kredibilitet sepse është e sigurt se pronarët e këtyre bizneseve të privatizuara kanë pasur kontakte direkte me zyrtarët e AKM-së. Pas AKM-së vijnë gjykatat me një intensitet prej 67.7, e përcjellur nga administrata qendrore me një intensitet prej 67.2 dhe nga administrata lokale me një intensitet prej 65.6. Pas tyre radhiten Doganat, UNMIK-u, Sektori i Arsimit dhe Organizatat e Tjera Ndërkombëtare. Shërbimi Policor i Kosovës konsiderohet të jetë institucioni me më së paku korrupsion.

**Tabela 7.3.2 Perceptimet e ndërmarrësve lidhur me intensitetin e korrupsionit në institucione të ndryshme**

Institucionet	Intensiteti
Sektori i Shëndetësisë	82.7
AKM (Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit)	82.1
Gjykatat	67.7
Administrata Qendrore	67.2
Administrata Lokale	65.6
Doganat	62.5
UNMIK-u	60.8
Sektori i Arsimit	50.8
Organizatrat e Tjera Ndërkombëtare	39.5
Shërbimi Policor	37.7

Note: the intensity of corruption ranges from 0 to 100.

Sa i përket rezultateve lidhur me prezencën e korrupsionit dhe se sa është niveli i intensitetit të tij, ato paraqesin vetëm perceptimet e ndërmarrësve prandaj duhet të merren me kujdes shumë të madh. Këto perceptime, në kohë të ndryshme mund të kenë ndikim nga faktor të jashtëm, që në të kundërtën mund të ndodhë që mos ta përfaqësojnë situatën në terren.

Për ta zvogëluar hapësirën ndërmjet korrupsionit të perceptuar dhe të përjetuar, ne i kemi pyetur respondentët se në çka i bazojnë opinionet e tyre. Ne parapra- kisht kemi supozuar se ekziston dallimi ndërmjet nivelit të perceptimit të korrup- sionit dhe përfshirjes direkte në të. Ky supozim është vërtetuar se ka qenë korrekt, sepse vetëm rreth 25 % e menaxherëve të bizneseve të privatizuara kanë shprehur opinionet e tyre për praninë e korrupsionit në përvojat e tyre, krahasuar me rreth 20 % të menaxherëve të firmave të tjera. Ndërsa sa i përket kompanive që janë privatizuar ndërmjet spin-ofit special, edhe pse gjysma e tyre e perceptojnë se niveli i korrupsionit është shumë i lartë, vetëm 18 % prej tyre i kanë bazuar këto perceptime në përvojat e tyre. Të tjerët, megjithatë i kanë bazuar opinionet e tyre për praninë e korrupsionit në informacionet që kanë marrë nga burimet e tjera duke përfshirë edhe burimet familjare, mediat apo nga të tjerët (Tabela 7.3.3).

**Tabela 7.3.3 Burimet e informacioneve në të cilat perceptimet e korrup- sionit janë të bazuara (%).**

Burimi i Informacionit	Kompanitë e Privatizuara	Kompanitë e tjera Private
Përvoja Personale	25.3	19.3
Bisedimet me shoqëri	24.0	27.0
Informatat nga Mediat	40.0	53.5
Burimet tjera	10.7	0.2
Totali	100.0	100

Për të zvogëluar gjasat e kompanive për të marrë pjesë në korrupsion, qeveria duhet të punojë në mbajtjen e lidhjes ndërmjet kompanive dhe zyrtarëve qeveritarë në nivel të ulët. Mirëpo edhe pse ka pasur tentime për të mbajtur këto lidhje në nivel të ulët, prapë po duket që zyrtarët qeveritarë ende kanë mundësi të kenë ndi- kime të forta diskriminuese lidhur me delegimin e shërbimeve të tyre, prandaj edhe kanë mundësi që të kërkojnë mito për kryerjen e këtyre shërbimeve. Për më tepër, dënimi që ata mund të marrin nëse vërtetohet se janë të përfshirë në korrupsion është shumë i vogël dhe nuk paraqet një përmbajtje të mjaftueshme për ti mbajtur larg ata nga krimet apo mizorit zyrtare.

Si përmbledhje, korrupsioni në Kosovë mund të mos jetë aq depërtues qysh per- ceptohe. Megjithatë më tepër duhet të bëhet për të përforcuar rendin dhe ligjin. Imponimi i rregullave transparente në pozita kyçe administrative, ku ndërlidhja me komunitetin e biznesit është e lartë, do të kontribuojë drejt zvogëlimit të korrup- sionit. Për më tepër, komuniteti i biznesit duhet të raportojë rastet nëpër të cilat kërkohet që të paguhet mito. Ndërsa në anën tjetër, nëse sulmojmë anën ofertuese të korrupsionit<sup>9</sup>, ne po themi se komuniteti i biznesit duhet të jetë i vetëdijshëm

<sup>9</sup> Me anën e ofertës së korrupsionit ne nuk po themi se firmat vullnetarisht ofrojnë mito, atom ë tepër e shohin korrupsionin si një qmim që duhet të paguhet për me ju ofrue atyre shërbime.

se edhe pse korrupsioni mund të ketë një rol lehtësues në treg, ai është gjithmonë në kosto të ndonjë firme tjetër dhe kjo në të kundërtën e degjeneron tregun. Si pasojë kjo do të rezultojë në profite më të vogla për shkak të nivelit të rritjes së vazhdueshme të korrupsionit. Komuniteti i biznesit duhet të jetë më i vendosur kur të bënë kërkimin e nivelit më të lartë të përgjegjësisë nga zyrtarët qeveritarë. Pas arritjes së kësaj vetëdije, atëherë komuniteti i biznesit mund të transformohet në një aktor të rëndësishëm për kontrollimin e korrupsionit.





# ÇËSHTJET E LIDHURA ME PROCESIN E PRIVATIZIMIT

## Dorëzimi dhe Menaxhimi

Duke përcjellur debatet rreth procesit të privatizimit në fazat e para fillestare, procesi dukej se po vazhdon me një tempo të kënaqshme, kur prapë procesi i privatizimit u ndërpre pas zgjidhjes së statutit politik të Kosovës. Trashëgimtari i AKM-së, AKP-ja (Agjencioni Kosovar i Privatizimit) filloj të funksionoj në Shtator 2008 pas disa muajve të mos funksionimit. Edhe pse AKP si organ autoritativ me kompetence të plotë që të fillojë procesin e privatizimit, nuk kishte ndonjë dorëzim zyrtar të mandatit nga AKM-ja në organin e ri 'AKP'. Kjo sugjeron një komunikim të dobët ndërmjet dy organizmave, ku si pasojë e kësaj edhe dëmtohet procesi në tërësi. Kështu që Dorëzimi zyrtar nga AKM-ja në AKP ende është i pakryer. Një çështje tjetër që duhet të adresohet është përgatitja më e mire e procesit të kontratave dhe procesit të Dorëzimit të kompanive të reja (NewCos) tek blerësit e këtyre kompanive. Sipas anketës sonë, ky proces në përgjithësi merr diku prej 10 deri rreth 12 muaj. Masat duhet të merren që i tërë ky proces të përfundohet brenda tre apo gjashtë muajve. Kjo është edhe më shumë e rëndësishme kur kemi parasysh se shumica e këtyre kompanive vazhdojnë ti kryejnë apo servisojnë borxhet e tyre derisa të bëhet Dorëzimi i pronësisë së ndërmarrjes.

Është e rëndësishme dhe e domosdoshme që AKP-ja të bëhet më transparente sesa AKM-ja në praktikën e saja. Gjithashtu, është e domosdoshme që një raportim i mirë i AKP-së të bëhet tek qeveria dhe parlamenti. Ndërtimi i një reputacioni të mirë për këtë Agjencion është një prej parakushteve kryesore për tërheqjen e më shumë investitorëve.

## Të Drejtat e Punëtorëve

Të ardhurat nga privatizimi mbahen në mënyrë që të paguhen pronarët dhe kreditorët në likuidimin e ndërmarrjeve të vjetra me pronësi shoqërore, si dhe për të bërë disa pagesa statutores për ata punëtorë të kaluar dhe aktualë të kompanisë së privatizuar që ju takojnë me ligj. Sipas rregullave relevante, punëtorëve të kompanive të privatizuara sipas prioriteteve ju takojnë 20 % e të ardhurave nga shitja e aseteve të privatizuara (pa marrë parasysh se a është 'Kompani e re - NewCo', tokë apo likuidim). Gjithashtu AKM-ja do ta vendosë shumën e rezervuar në një llogari mirëbesimi për t'u shpërndarë punëtorëve nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK).

Punëtorët mund të marrin pjesë në këtë 20 % vetëm nëse ata janë të regjistruar si punëtor me Ndërmarrjet Shoqërore (NSH-të) në kohën e privatizimit apo inicimit të likuidimit, si dhe ai punëtor ka qenë në sistemin e pagave të NSH-së për jo më pak se tri vite (në çdo kohë). Për të vërtetuar se kujt i takojnë këto përfitime, grupi përfaqësues i punëtorëve në NSH, në bashkëpunim me BSPK-në, do të zgjedhin një listë në baza jo diskriminuese me emrin e punëtorëve që ju takojnë këto përfitime dhe të njëjtën e dorëzojnë në AKM.

Më herët, AKM-ja nuk i ka rishqyrtuar këto lista prandaj punëtorët kanë ngritur ankesa direkt me Dhomën e Veçantë. Prej se është bërë amandamenti i rregullave 2006/78, AKM-ja së pari duhet të publikojë një listë të punëtorëve të zgjedhur për përfitime sipas ligjit dhe brenda 20 ditëve çdo person ka të drejtë që të parashtrojë kërkesën për kundërshtimin e kësaj liste. Atëherë AKM-ja do të kërkojë paraqitjen e evidencës dhe më pas mund të mbajë seancë shqyrtimi. Pas kësaj, do të adoptojë listën dhe do ta publikojë atë. Vetëm pas kësaj procedure, punëtorët mund të ankojnë tek Dhoma e Veçantë ku Agjencioni do të jetë si respondent<sup>10</sup>.

Problemi kryesor megjithatë mbetet sepse këtyre institucioneve si AKM-ja, Dhoma e Veçantë, ju mungojnë resurse të mjaftueshme për ti zgjidhur këto ankesa në mënyrë efektive. Si pasojë vonesat në këtë proces janë paraqitur.

Duke u bazuar në të dhënat që ne kemi marrë nga AKM-ja në të cilën i referohen situatës deri në fund të Qershorit 2008, shifrat sa i përket vlerës neto të 20 % që ju takojnë punëtorëve që i plotësojnë kushtet ishte 76,638,603 Euro, ku prej tyre vetëm 15,567,824 Euro (apo 21.3% e totalit) ju është paguar këtyre punëtorëve. Ky është një nivel shumë i vogël i pagesave që ju është bërë punëtorëve pas katër viteve të privatizimit. BSPK-ja ka qenë shumë e shqetësuar për këtë situatë dhe shqetësimet e tyre janë rikonfirmuar në takimin tone me kryetarin e kësaj organizate, i cili shprehu një shqetësim të madh për situatën e krijuar. Ata kërcënojnë për greva masive nga punëtorët nëse procesi nuk rifillon me një shpejtësi më të madhe. Sipas tyre AKM-ja (tash AKP-ja) duhet të rifillojë që të paguajë shumicën e vlerës së mbetur, me disa fonde rezerve që ende do të vazhdojnë të mbahen nga AKP-ja për pagesat eventuale të kërkesave ligjore të aprovuara ndaj NSH-së. Për më tepër, ata shprehin shqetësimet e tyre të mëdha lidhur me kapacitetet e kufizuara të AKP-së për të shqyrtuar këto kërkesa ndaj NSH-ve, duke besuar se numri i stafit që është duke u marrë ekskluzivisht me këtë punë duhet të rritet në mënyrë të konsiderueshme. Shihet qartë se duhet të kemi një vullnet më të madh politik për shpejtimin e procesit të pagesave të 20 % të të ardhurave nga procesi i privatizimit, proces ky që ka stagnuar qysh nga Qershori i vitit 2007.

Në përfundim, AKM-së (dhe APK-së momentalisht) ju mungojnë resurset e nevojshme për implementimin e pagesave të 20 % të procesit të privatizimit në mënyrë efektive për ata punëtorë që i përmbushin kushtet e cekura më lartë; gjithashtu një rishqyrtim i disa vendimeve të Dhomës së Veçantë nga OSBE-ja, paraqet se ka edhe aty ka të meta siç është: dështimi për publikimin e vendimeve të Dhomës së Veçantë, supozimi jo korrekt i autoriteteve nga gjykatat e rregullta për lëndët që është dashur të shqyrtohen nga Dhoma e Veçantë, si dhe interpretimi i dobët i avokatëve para gjykatave. Të gjitha këto çështje duhet të adresohen me një prioritet të lartë sepse ato paraqesin një parakusht për rifillim të suksesshëm dhe një përshpejtim të procesit.

<sup>10</sup> OSCE, May 2008 'Judicial Review of Kosovo Trust Agency Matters by the Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo'

## Të ardhurat e Privatizimit dhe funksioni i tyre ekonomik

Funksioni i të ardhurave nga shitja e asetëve të NSH-ve dhe shfrytëzimi ekonomik i tyre ka mbetur një prej çështjeve më të diskutuara të procesit të privatizimit në Kosovë. Vlera e përgjithshme e të ardhurave që janë grumbulluar nëpërmjet procesit të privatizimit është rreth 383 milion euro. Pasi që këto asetë janë të bllokuara në llogari bankare, ato janë të larguara nga aktivitetet ekonomike, prandaj edhe kanë një efekt negativ në zhvillimin ekonomik. Përderisa 20 % i këtyre të ardhurave duhet që tu paguhet punëtorëve, pjesa e tjetër mbahet e bllokuar në mënyrë që të adresojë obligimet potenciale si dhe kërkesat e tjera nga kreditorë brenda dhe jashtë Kosovës. Kjo zgjidhje ishte adoptuar nga rregullorja e AKM-së (Qershor 2002) edhe pse ishte kundërshtuar nga ekspertët Kosovar dhe ndërkombëtar. Siç po shihet, ky ishte një çmim politik që është dashur për tu paguar në mënyrë që procesi i privatizimit të fillojë. AKM-ja si administrues i besuar i këtyre fondeve dhe autoritetet ligjore të Kombeve të Bashkuara kanë kundërshtuar qasjet dhe zgjidhjet e tjera që do të sillnin këto të ardhura më afër për tu përdorur dhe për tu sfiduar me problemet aktuale ekonomike dhe sociale.

Njësitë Federale të tjera të ish Jugosllavisë i kanë përdorur të ardhurat e privatizimit sipas prioriteteve të tyre zhvillimore si dhe nevojave të tjera sociale. Ato nuk kanë rezervuar asnjë pjesë të këtyre të ardhurave për ti adresuar kërkesat e kreditorëve potencial nga njësitë e tjera Federale të Jugosllavisë. Si pasojë, nëse ndonjë kompani Kosovare ka kërkesa kundër NSH-ve të tjera në Serbi apo diku tjetër në Jugosllavi, ato nuk kanë mundësi as që të parashirojnë kërkesën kundër të ardhurave të privatizimit në atë entitet. Përvojat e vendeve të tjera janë se një fond i dëmshpërblimeve krijohet nga një përqindje e vogël e të ardhurave të privatizimit (zakonisht më pak se 10 %) për tu ballafaquar me kërkesat e ardhme pronësore.

Duke pas parasysh se të ardhurat nga privatizimi janë duke u rritur, të grumbulluara në fonde të besueshme, si dhe duke pas parasysh se nuk dihet se kur Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme do ti adresojë këto kërkesa relevante, ne konsiderojmë që këto çështje duhet të adresohen prapë dhe një zgjidhje më e arsyeshme duhet të gjendet. Siç po shihet, në këtë moment zgjidhja më e mirë do të ishte nëse themelojmë një fond të dëmshpërblimeve prej 10-15% nga të ardhurat e privatizimit për të adresuar kërkesat potenciale të arsyeshme gjatë 3-5 viteve të ardhshme. Qeveria e Kosovës mund të garantojë që do ti mbulojë kërkesat e arsyeshme nëpërmjet buxhetit të saj nëse e tejkalojnë atë shumë e deri në shumën e përgjithshme të të ardhurave që janë grumbulluar nga shitja e asetëve të përgjithshme të NSH-ve të kaluara. Fondet në dispozicion atëherë mund të përdoren për nevojat investuese afatgjate të vendit.

## REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA

Belka, Marek, Saul Estrin, Mark Schaffer and I. Singh, 1995, 'Enterprise Adjustment in Poland: Evidence from a Survey of 200 Private, Privatized and State-Owned Firms,' - CEPR Discussion Paper No. 223 (London: Centre for Economic Policy Research).

Djankov, Simeon and Gerhard Pohl, 1998, 'Restructuring of Large Firms in the Slovak Republic,' *Furthercoming*, The Economics of Transition.

Djankov, Simeon and Murrell, Peter, 2002, 'Enterprise restructuring in Transition: A quantitative survey,' - *Journal of Economic Literature*, February 2002

Earle, John and Saul Estrin, 1996, 'Worker Ownership in Transition,' in *Corporate Governance in Central Europe and Russia*, Vol. 2, ed. By Roman Frydman, Cheryl Gray and Andrzej Rapaczynski (London: Central European University Press).

European Consultants Organization (2008) - 'Post Privatization Survey for the Kosovo Trust Agency (KTA)' July 2008

Frydman, Roman, Cheryl W. Gray, Marek Hessel and Andrej Rapaczynski, 1997, 'Private Ownership and Corporate Performance - Some Lessons from Transition Economies,' - World Bank Policy Research Working Paper No. 1983 (Washington: The World Bank).

Harper, Joel T., 2000, 'The Performance of Privatized Firms in the Czech Republic,' - working paper, Florida Atlantic University, Boca Raton, FL.

Harvylyshyn, O. & Mc Gettigan, D. (1999). 'Privatization in transition countries: Lessons of the first decade' - *Economic Issues*, August, No.18

Megginson, William, Robert Nash and Matthias Van Randenborgh, 1994, 'The Financial and operating Performance of Newly Privatized Firms: An International Analysis,' - *The Journal of Finance*, Vol. 49, pp. 403-452

Megginson, William, Robert. Nash, Jeffry Netter, and Adam Schwartz. 2000. 'The Long Term Return to Investors in Share Issue Privatizations,' - *Fin. Manag.*, 29, pp. 67-77.

Murrell, Peter, 1992, "Privatization versus the Fresh Start" in *Uprooting Leninism, Cultivating Liberty*, ed. By Tisfmaneanu, V. and P. Clawson (Philadelphia: University Press of America).

OSCE (2008) - 'Judicial Review of Kosovo Trust Agency Matters by the Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo' - Prishtina, May 2008

Pohl, Gerhard, Simeon Djankov and Robert Anderson, 1996, 'Restructuring Large Industrial Firms in Central and Eastern Europe-An Empirical Analysis,' - World Bank Technical Paper No. 332 (Washington: The World Bank).

Riinvest Institute (2001) – ‘Ndërmarrjet shoqërore dhe privatizimi’- Qershor 2001, Prishtinë

Riinvest Institute (2002) – ‘Privatizimi i NSH-ve dhe reformimi i shërbimeve publike në Kosovë’ - Qershor 2002, Prishtinë

Riinvest Institute (Forum 2015) (2004) – ‘Privatizimi në Kosovë: Përparimet dhe ngecjet’ - 2004, Prishtinë

Riinvest Institute (Forum 2015) (2004) – ‘Statusi i pronës shoqërore në Kosovë: Kontestet dhe privatizimi’ – 2004, Prishtinë

Vining, Aidan and Anthony Broadman, 1992, ‘Ownership Versus Competition: Efficiency in Public Enterprises,’ - Public Choice, Vol.73, pp. 205-239.

World Bank, 1996, From Plan to Market – World Development Report (Washington: The World Bank).



# SHTOJCAT

## SHTOJCA 1: Metodologjia e detajuar

### Anketa

Të dhënat janë grumbulluar përmes intervistave sy-më-sy me njerëzit e ndërmarrjes; pronarë apo menaxher të cilët janë të njoftuar me zhvillimet në ndërmarrje si dhe janë të autorizuar t'i ofrojnë këto informacione. Anketa është implementuar duke përdorur një pyetësorë gjithëpërfshirës me mbi 120 pyetje. Pyetësori për ndërmarrjet private ishte i njëjtë me atë të ndërmarrjeve të privatizuara (përveç pyetjeve që ishin relevante për ndërmarrjet e privatizuara) në mënyrë që të mundësohen krahasimet. Anketa në terren është bërë nga studentët më të mirë të programeve të magjistraturës të Universitetit Riinvest të cilëve u ishin caktuar intervistat e përgjithshme për rastet studimore përderisa intervistat me menaxherët e ndërmarrjeve janë bërë nga studentët e studimeve bazë të Universitetit Riinvest dhe Universitetit të Prishtinës të cilëve paraprakisht u është mbajtur trajnim dy ditor lidhur me metodologjinë, qasjen ndaj respondentit, qëllimet e hulumtimit si dhe lidhur me pyetësorin. Pas realizimit të anketës, ekipi i projektit ka bërë kontrollimin logjik që të vërtetoj saktësinë e të dhënave. Më pas, të dhënat janë futurë në bazë të të dhënave duke përdorur MS Excel dhe janë përpunuar duke përdorur pakon softuerike SPSS.

Mostra e ndërmarrjeve të privatizuara është bazuar në regjistrin elektronik të ofruar nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM). Mirëpo, mostra është zgjedhur vetëm nga lista e ndërmarrjeve të privatizuara para valës së 22-të (Mars 2007) që lë hapësirë më shumë se një vjeçare për pronarët e rinj që të marrin kontrollin mbi ndërmarrjet dhe të fillojnë operimin (edhe pse një gjë e tillë nuk rezultojë të jetë gjithnjë e vërtetë në praktikë). Nga numri i përgjithshëm i 367 ndërmarrjeve në listë që i përkasin valëve 1-21, ne kemi zgjedhur 108 sosh. Duke aplikuar metodat konvencionale të mostrimit, madhësia jonë e mostrës siguron rezultatet me nivel besueshmërie 95% dhe interval besimi 5. Për shkak të rëndësisë më të madhe në ekonomi, ne kemi përfshirë të gjitha 23 ndërmarrjet e privatizuara përmes spin off-it special, deri në valën 22. Pjesa e mbetur e mostrës janë zgjedhur me metodë të rastit nga regjistri elektronik<sup>11</sup>. Nga 108 ndërmarrjet e kontaktuar, 36 nuk funksionojnë ende. Në rastin e 5 kompanive, anketat janë anuluar pasi që në kohën e anketimit, pronari nuk ka nënshkruar kontratë apo ka marrë nën kontroll ndërmarrjen. Si rrjedhojë, rezultatet e prezantuara këtu bazohen në të dhënat e 67 ndërmarrjeve të privatizuara.

Mostra e sektorit privat (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) bazohet në regjistrin elektronik të bizneseve të marrë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në dhjetor të vitit 2007. Numri I bizneseve të regjistruara në këtë kohë ishte 82,000 mirëpo mostra është nxjerrë pas përjashtimit të kompanive publike; dhe në këtë

11 Regjistri i marrë nga AKM-ja nuk bën dallim ndërmjet ndërmarrjeve të privatizuara përmes spin off-it të rregullt apo likuidimit dhe se një gjë e tillë është vërejtur vetëm pas realizimit të anketave. Mund të diskutohet si e pa arsyeshme përfshirja e tyre në mostër, mirëpo ne kemi vendosur t'i mbajmë ato në mostër pasi që performanca e tyre nuk dallon substancialisht nga ajo e ndërmarrjeve të privatizuara përmes spin off-it të rregullt.

rast popullacioni mbetet në 51,281 ndërmarrje nga i cili numër është nxjerrë mostra. Mostra ka 500 ndërmarrje të vogla dhe të mesme; kjo mostër siguron rezultate në një nivel besimi 95% dhe interval besimi 4. Në mënyrë që të nxjerrim një mostër reprezentative, mostra është stratifikuar në bazë të sektorëve, rajonit dhe madhësisë. Stratifikimi në bazë të sektorëve dhe rajoneve është bërë në bazë të pjesëmarrjes së tyre në popullacion të NVM-ve (Tabela A2 dhe A3). Sidoqoftë, pasi që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të popullacionit, pjesëmarrja e tyre në mostër është rritur në mënyrë që të nxjerrim rezultate sa më reprezentative për këto grupe. (tabela A1).

**Tabela A.1: Stratifikimi në bazë të madhësisë**

Madhësia	Popullacioni i NVM-ve	Pjesëmarrja në popullacion	Pjesëmarrja në mostër
Micro	49,985	97.5%	70%
E vogël	1,092	2.1%	25%
E mesme	204	0.4%	5%
Total	52,281	100%	100%

**Tabela A.2: Stratifikimi në bazë të sektorit**

Sektori	Pjesëmarrja në mostër
Prodhimi	23%
Shërbimet	35%
Tregtia	42%
Total	100%

**Tabela A.3: Stratifikimi në bazë të rajonit**

Rajoni	Mikro ndërmarrje	Ndërmarrje e vogël	Ndërmarrje e mesme	Total
Prishtina	32.7%	40.8%	46.1%	32.9%
Prizren	13.5%	13.6%	8.3%	13.5%
Mitrovica	13.2%	10.0%	7.4%	13.1%
Ferizaj	11.0%	10.3%	7.8%	10.9%
Peja	12.3%	9.95	7.8%	12.2%
Gjilan	12.1%	8.7%	4.9%	12.0%
Gjakova	5.3%	6.7%	17.6%	5.3%
Total	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%



## SHTOJCA 2: PËRMBLEDHJE E RASTEVE STUDIMORE

### Rasti studimor: NewCo Ballkan Sh.P.K.

NewCo Ballkan Sh.P.K. është themeluar në vitin 1963 në Suharekë, Kosovë. Biznesi bazë i kësaj ndërmarrjeje është prodhimi i gomës dhe materialeve kimike. Kompania, në kapacitet të plotë, mund të prodhoj 14000 tona shirita transportues, 12 milion metra të shiritave të ngushtë V, katër milion metra katrorë të fabrikateve të gomës dhe 250 ton të gomës teknike. Në periudhën para privatizimit ndërmarrja ka pasur të punësuar mesatarisht 850 punëtorë. Ballkan Sh.P.K. ka pasur pozitë monopolistike në tregun vendorë dhe rajonal ndërsa konkurrenca ndërkombëtare kryesish vinte nga Kina dhe vendet e ish-Bashkimit Sovjetik.

### Procesi i privatizimit

Ballkan Sh.P.K. është një tregim i suksesshëm i procesit të privatizimit në Kosovë. Kompania është privatizuar me çmimin prej 1.4 milion eurove. Përveç çmimit të ofruar, kompania gjithashtu duhet përbushur edhe dy kushte tjera; të punësoj 378 punëtor dhe të investoj 6 milion euro.

### Periudha pas privatizimit

Ballkan Sh.P.K. pas privatizimit ka kontrolluar kapitalin fiks të kompanisë dhe momentalisht në bilancin e saj të gjendjes figurojnë: 6 milion euro ndërtesa, 10 milion euro teknologji, 300,000 euro në mjete transportuese dhe 3 milion euro në toka. Rreth 70% e prodhimit eksportohet në vendet si: Holanda, Finlanda, Gjermania, Italia, Maqedonia, Shqipëria dhe Turqia. Në periudhën 2006-2008, Ballkan Sh.P.K. ka investuar 4.5 milion euro dhe ekipi menaxhues planifikon të investoj edhe 1.5 milion euro tjera gjatë vitit 2008.

Ballkan Sh.P.K. është një kompani e njohur ndërkombëtarisht, me një brend të njohur shumë si në tregun vendorë ashtu edhe atë ndërkombëtar. Kompania e certifikuar për standardet ISO 9002/2000 për kualitet dhe së fundi ka marrë çmimin ndërkombëtar për emrin më të mirë tregtarë në këtë industri, Frankfurt 2002.

### Rasti studimor: Hotel Iliria – Prishtinë

NewCo Hotel Iliria Sh.P.K. është një ndër hotelet më të vjetra në Prishtinë, Kosovë. Aktiviteti bazë i kësaj ndërmarrjeje është hoteleria. Hoteli Iliria është privatizuar në vitin 2006 me çmim 1.6 milion euro. Para privatizimit aty kanë punuar 46 punëtorë

## Procesi i privatizimit

Hotel Iliria është privatizuar me metodën e spin off-it special. Profeci i privatizimit të kësaj kompanie është përmbyllur pa vonesa. Privatizimi I kësaj kompanie është bërë nga investitorë lokal në bashkëpunim me investitor të huaj. Përveç çmimit të ofruar, kompania është dashur të plotësoj edhe dy kushte tjera; të punësoj 250 punëtor dhe të investoj 3 milion euro.

## Periudha pas privatizimit

Sipas menaxherit financiar të kësaj ndërmarrjeje, ndërmarrja posedon pajisje të teknologjisë së nivelit të lartë gjë që konsiderohet të jetë një përparësi në krahasim me konkurrencën në treg. Vlera e përgjithshme e kapitalit fiks vlerësohet të jetë 8.2 milion euro. Përderisa para privatizimit, në Prishtinë, ka pasur shumë më pak hotele, tani ka dhjeta apo qindra sosh. Disa prej tyre operojnë pa ndonjë licencë dhe në këtë mënyrë dëmtojnë konkurrencën fer dhe rrjedhimisht edhe ndërmarrjen NeëCo Hotel Iliria Sh.P.K.

Kompania ka investuar shumë në infrastrukturë dhe pajisje. Vlera e investimeve të planifikuara për këtë vit sillet rreth 3 milion euro. Pengesat kryesore sipas menaxhmentit të kësaj kompanie janë: konkurrenca jo-fer, vonesat në pagesa nga institucionet publike duke qenë se ky sektor është klienti më i madh i kësaj kompanie.

## Rasti studimor: M&Sillosi

NewCo M&Sillosi është themeluar në vitin 1977. Biznesi bazë i M&Sillosi është prodhimi i miellit si prodhim primar dhe pastat si prodhim sekondar. Para privatizimit, ndërmarrja ka pasur të punësuar 320 punëtor përderisa tani ajo ka 120 punëtorë prej të cilëve 90% kanë punuar në kompani edhe para privatizimit. Kapaciteti prodhues i kësaj ndërmarrjeje para privatizimit ka qenë 240 ton në ditë përderisa tani ai është 60 ton në ditë.

## Procesi i privatizimit

Sipas deklarimeve të menaxhmentit, që nga koha e privatizimit ndërmarrja ka investuar rreth 20 milion euros. Investimet si dhe blerja e kompanisë në procesin e privatizimit janë bërë nga investitor të huaj dhe lokal. Shumica e investimeve janë fokusuar në teknologji.

## Periudha pas privatizimit

NewCo M&Sillosi prodhon kryesisht për tregun vendor, 80% e prodhimeve i shet në tregun e brendshëm përderisa 20% I eksporton në vendet fqinje si Shqipëria dhe Maqedonia. Konkurrenca për këtë kompani vjen kryesisht nga vendet fqinje. Përparësia më e madhe krahasuese e NewCo M&Sillosi mbi konkurrencën është kualiteti i prodhimit të tyre.

Pengesa kryesore e kësaj kompanie në Kosovë është ekonomia jo-formale. Ka shumë artikuj të ngjashëm që futen në tregun e Kosovës pa paguar ndonjë tatim si dhe pa pasur ndonjë kontroll të rreptë të cilësisë.

## Rasti studimor: NewCo Alferon – ish Ferronikeli Sh.P.K.

Ferronikeli Sh.P.K. është themeluar në vitin 1978 përderisa prodhimin e ka filluar në vitin 1985. Veprimtaria bazë e kësaj ndërmarrjeje është prodhimi i Ferronikelit (FeNi). Para privatizimit, kompania ka eksportuar 90% të produktit të saj përderisa 10% të mbetura janë shitur në vendet e ish-Jugosllavisë. Dikur, kompania prodhonte 6800 ton ferronikën në vit ku ishin të punësuar rreth 2000 punëtorë. Kompania është shkatërruar shumë gjatë luftës së vitit 1999 dhe kjo është arsyeja kryesore pse nuk ka funksionuar deri në qershor të vitit 2007.

## Procesi i privatizimit

NewCo Kompleksi Ferronikeli Sh.P.K. është privatizuar në vitin 2006 me një çmim prej 30.5 milion eurove. Kompania është privatizuar përmes metodës së spin off-it special dhe duhet të plotësoj edhe kushte tjera. Sipas këtyre kushteve, kjo kompani obligohet që të bëj investime në vlerë minimale prej 20 milion euro, 3 milion euro për kompensim të pronave dhe të punësoj 1000 punëtorë në vitin e parë. NewCo Kompleksi Ferronikeli Sh.P.K. menaxhohet nga Alferon Management Limited, me seli qendrore në Londër, MB.

## Periudha pas privatizimit

Aktualisht, kompania nuk është duke operuar me kapacitete të plota. Në vitin 2007 (korrik-dhjetor) kompania ka prodhuar 1000 ton ferronikel, përderisa kapaciteti i prodhimit sillet rreth 10000 ton ferronikel në vit. Në vitin 2008, kompania ka punuar me kapacitet të plotë me një linjë prodhimi. Menaxhmenti i kompanisë planifikon që të filloj me linjën e dytë të prodhimit këtë vit. I gjithë prodhimi është eksportuar në vendet si India, Belgjika dhe Norvegjia. Kompania ka deklaruar se nuk ka pasur probleme me proceduar e realizimit të eksportit. Sipas menaxhmentit të kësaj kompanie, NewCo Kompleksi Ferronikeli Sh.P.K. është duke i kontribuar pozitivisht bilancit tregtar të Kosovës.

Aktualisht ndërmarrja ka 1037 punëtorë. Gjithashtu ndërmarrja punëson punëtorë me orarë të pjesshëm varësisht nga nevojat e paraqitura. Sipas menaxhmentit të kësaj kompanie, NewCo Kompleksi Ferronikeli Sh.P.K. nuk pritet rritje e numrit të punëtorëve edhe pse niveli i prodhimit pritet të rritet.

## PËR FORUM 2015

Forum 2015 është një projekt i Fondacionit SOROS dhe Institutit RIINVEST, që ofron ekspertizë dhe avokon për çështjet zhvillimore në Kosovë. Forum 2015 përmes aktiviteteve të ndryshme, nxit debate mbi tema aktuale dhe ndihmon zhvillimin e një kulture të avancuar politike. Në perspektivë të gjerë, Forum 2015 synon përgatitjen e Kosovës për integrim në struktura Euro-Atlantike.

### Tryezat e deritashme të diskutimeve

#### seminaret dhe konferencat

Kosova dhe Bota Arabe II (konferenca në Prishtinë) – 25 Gusht 2008

Kosova dhe Bota Arabe I (konferenca në Amman) – 14 Korrik 2008

Absorbimi i fondeve të para-anëtarësimit në BE – 11 Prill 2008

Diaspora dhe Politikat e Migracionit – 18 Dhjetor 2007

Puna e Kuvendit të Kosovës 2004-2007 (dokumentar) – Nëntor 2007

Platforma Civile për Zgjedhjet 2007 – 31 Tetor 2007

Identiteti Evropian i Kosovës – 26 & 27 Qershor 2007

Politika e Jashtme e Kosovës pas statusit – 9 Maj 2007

Një Përrallë Moderne – Kosova C 2100 – 18 Prill 2007

Statusi pas statusit - Prezenca e ardhshme ndërkombëtarë në Kosovë  
14 Dhjetor 2006

Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor – 10 Nëntor 2006

Dialogu i decentralizimit në Kosovë – 14 Qershor 2006

Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë – 18 Maj 2006

Kultura fiskale dhe qëndrueshmëria buxhetore – 19 Janar 2006

60 vjetori i OKB-së – Një zhvillim për të gjithë – 24 Tetor 2005

Statusi kundër status quos – 1 Qershor 2005

Mediat në Kosovë: sfidat e gazetarisë së pavarur dhe të qëndrueshme  
21 Mars 2005

Kosova dhe integrimi i saj në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë  
23 Dhjetor 2004

Kosova pas pesë vitesh: cila është ardhmëria? – 9-10 Korrik 2004  
Statusi i pronës shoqërore në Kosovë: kontestet dhe privatizimi – 4 Qershor 2004  
Privatizimi në Kosovë: mbarëvajtja dhe pengesat – 9 Mars 2004  
Sistemi zgjedhor në Kosovë: përparësitë dhe të metat – Shkurt 2004  
Operacionalizimi i standardeve – 26 Nëntor 2003  
Platforma e dialogut Prishtinë-Beograd – 7 Tetor 2003  
Samiti i Selanikut – sfidat e integritit evropian – 11 Qershor 2003

## **Publikimet e deritashme**

Një Përrallë Moderne – dokumentar mbi projektin Kosova C – Prill, 2008  
Absorbimi i fondeve të para-anëtarësimit në BE – Prill, 2008  
Diaspora dhe Politikat e Migracionit – Dhjetor, 2007  
Puna e Kuvendit të Kosovës 2004-2007 (dokumentar) – Nëntor, 2007  
Identiteti Evropian i Kosovës – Nëntor, 2007  
Platforma Civile për Zgjedhjet 2007 – Tetor, 2007  
Politika e Jashtme e Kosovës – Shtator, 2007  
Një Përrallë Moderne – Kosova C 2100 – Prill, 2007  
Statusi pas statusit – Prezenca ndërkombëtare në Kosovë – Shkurt, 2007  
Decentralizimi në Kosovë – Manual informativ – Janar, 2007  
Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor – Nëntor, 2006  
Arsimi i lartë për minoritetet në Kosovë – Shtator, 2006  
Kosova pesë vite më vonë – Çfarë agjende për të ardhmen? – 2005  
Pse pavarësia? – Shtator, 2005  
Privatizimi në Kosovë – Përparimet dhe ngeçjet – Mars, 2004  
Për më shumë [www.forum2015.org](http://www.forum2015.org)

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

338.246.025(496.51)(047)

Privatizimi dhe post-privatizimi në Kosovë : një  
gotë gjysmë boshe apo gjysmë e plotë? : (raport  
studimor) / [Muhamet Mustafa..et al.]. - Prishtinë :  
Forum 2015, 2008. - 38 f. : ilustr ; 30 cm.

Referencat dhe bibliografia : f. 32-33

1. Mustafa, Muhamet

**ISBN 978-9951-506-08-3**